



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

RREGULLORE

MBI

MASAT E VIGJILENCËS SË DUHUR DHE TË ZGJERUAR NGA SUBJEKTET
E LIGJIT MBI PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE
FINANCIMIT TË TERRORIZMIT

Miratuar me Vendim Bordi nr. 58, datë 30.06.2015
Ndryshuar me Vendim Bordi nr. 135, datë 21.12.2015
Ndryshuar me Vendim Bordi nr. 24, datë 26.02.2018
Ndryshuar me Vendim Bordi nr. 214, datë 31.10.2018

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i procedurave dhe dokumentacionit për identifikimin e klientit, regjistrimin, ruajtjen e të dhënave dhe raportimin e tyre tek autoriteti përgjegjës (DPPPP) nga subjektet e kësaj rregulloreje.

Neni 2
Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim parandalimin e përdorimit të subjekteve për pastrimin e parave dhe/ose financimin e terrorizmit.

Neni 3
Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje sipas germave e) dhe ë) të nenit 3 të Ligjit nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, janë :

- Bursat dhe çdo subjekt tjetër (agjent, broker, shoqëri brokerimi, etj.) që ushtron veprimtari për emetimin, këshillimin, ndërmjetësimin, financimin dhe çdo shërbim tjetër që ka lidhje me tregtimin e titujve;
- Shoqëritë që merren me sigurimin e jetës ose risigurimit, agjentët apo ndërmjetësit e tyre, si dhe fondet e pensionit.

Neni 4 Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në bazë të pikës 2, të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, pikës 2, të nenit 24, të Ligjit nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar dhe nenit 7, të Ligjit nr. 157, datë 10.10.2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”.

Neni 5 Përkufizime

“**Autoritet përgjegjës**” është Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP).

“**Autoritet mbikëqyrës**” është Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) .

“**Vigjilenca e duhur**” është tërësia e masave që duhet të aplikojnë subjektet, me qëllim identifikimin dhe verifikimin e plotë dhe të saktë të klientëve, pronarit përfitues përfundimtar, strukturës së pronësisë dhe të kontrollit për personat juridike dhe organizimet ligjore, natyrën dhe qëllimin e transaksionit apo marrëdhënies, si dhe monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënieve të biznesit dhe të shqyrtimit të vazhdueshëm të transaksioneve, për të siguruar që janë në përputhje me natyrën e biznesit të klientit dhe profilet e rrezikut, duke përfshirë, kur është e nevojshme, burimin e fondeve.

“**Vigjilenca e zgjeruar ndaj klientit**” është një proces më i thellë kontrolli, përtej procedurave “Njihe klientin tënd” që synon të krijojë sigurinë e mjaftueshme për të verifikuar dhe vlerësuar identitetin e klientit; për të kuptuar dhe testuar profilin e klientit; të biznesit dhe veprimtarisë së llogarive të tij bankare; për të identifikuar informacionet me rëndësi dhe për të vlerësuar rrezikun e mundshëm për pastrim parash/ financim terrorizmi, në mbështetje të vendimeve që synojnë mbrojtjen nga rreziqet financiare, rregullatore apo reputacionale, si dhe përshtatjen ndaj kërkesave ligjore.

“**Subjekt**” është personi fizik ose juridik që vendos marrëdhënie biznesi me klientë, gjatë veprimtarisë së tij normale apo si pjesë e veprimtarisë tregtare ose profesionale të tij.

Termet e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përdorur në Ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar, dhe Ligjin nr. 157, datë 10.10.2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tyre.

KREU II

VIGJILENCA E DUHUR DHE E ZGJERUAR

Neni 6

Masat parandaluese të ndërmarra nga subjektet

1. Subjektet e Ligjit nr. 9917, datë 19.05.2008, identifikojnë në mënyrë të plotë dhe të saktë klientët e tyre dhe personat përfitues, si dhe kërkojnë informacione shitesë në rastet kur e gjykojnë të arsyeshme.
2. Subjektet bëjnë verifikimin e identitetit të klientit nëpërmjet dokumenteve ligjërish të vlefshme. Dokumentet që paraqiten nga klienti pranë subjektit duhet të jenë origjinale ose fotokopje e noteruar. Subjektet, në momentin e vendosjes së marrëdhënieve të biznesit ose kryerjes së transaksionit/eve, mbajnë në dosjen e klientit kopje të dokumenteve të paraqitura nga ky i fundit. Kopjet e këtyre dokumenteve duhet të jenë të vulosura me vulën e subjektit, brenda afatit të vlefshmërisë së tyre.
3. Në rastin e përfaqësimit të klientit nga një person i tretë nëpërmjet një akti përfaqësimi, subjektet kërkojnë të dhëna për identifikimin e klientit dhe të përfaqësuesit të tij, si dhe mbajnë në dosjen e klientit të gjithë dokumentacionin e paraqitur prej personit të tretë, duke përfshirë dhe origjinalin ose kopjen e noteruar të aktit të përfaqësimit.
4. Subjektet, përpara se të vendosin marrëdhënie biznesi dhe/ose të kryejnë transaksione në emër dhe për llogari të klientit, konsultojnë listën e përditësuar të personave të shpallur si financues të terrorizmit, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave sipas Ligjit nr. 157, datë 10.10.2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit” dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.
5. Subjektet refuzojnë kryerjen e transaksioneve dhe nuk hyjnë në marrëdhënie biznesi, në rast se nuk plotësohen kërkesat për identifikimin e tij dhe kërkesat për vigjilencën e duhur parashikuar në kreun III të Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave.
6. Në rast se subjektet në çdo kohë dyshojnë për identitetin e klientit, ato pezullojnë menjëherë çdo veprim me të si dhe njoftojnë autoritetin përgjegjës, në përputhje me kërkesat për raportim të përcaktuara në nenin 9 të kësaj rregulloreje.

Neni 7

Regjistrimi dhe ruajtja e të dhënave

Subjektet regjistrojnë në bazën e tyre të të dhënave çdo informacion që ka lidhje me identifikimin e klientit dhe për çdo transaksion financiar të kryer në emër ose për llogari të tij. Ruajtja e këtij informacioni, së bashku me dokumentacionin mbështetës, kryhet sipas kërkesave dhe afateve të përcaktuara në nenin 16, të Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave.

Neni 8

Strukturat përgjegjëse të subjekteve

1. Subjektet krijojnë strukturën/at dhe infrastrukturën e nevojshme në funksion të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.
2. Subjektet caktojnë një person përgjegjës në nivel administrimi/ drejtimi në zyrën qendrore për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga Ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij. Personi përgjegjës ka akses të vazhdueshëm ndaj të gjitha të dhënave dhe në çdo lloj informacioni që disponohet nga subjekti, i cili është i nevojshëm për përmbushjen e detyrave.
3. Strukturat përkatëse të subjektit vënë në dispozicion të personit përgjegjës, të caktuar sipas pikës 2 të këtij neni, mjetet dhe burimet e mjaftueshme për përmbushjen e funksionit të tij (si për shembull teknikën e përshtatshme, personelin e mjaftueshëm, një buxhet të arsyeshëm etj.) si dhe përgatisin një program trajnues të vazhdueshëm për personin përgjegjës.
4. Subjektet njoftojnë Autoritetin përgjegjës dhe mbikëqyrës për emrin e personit përgjegjës të caktuar sipas pikës 2 të këtij neni, si dhe në të gjitha rastet që ka ndryshime të këtij personi.
5. Subjektet i vënë në dispozicion Autoritetit përgjegjës dhe mbikëqyrës, menjëherë pas miratimit të tyre, kopje të procedurave të brendshme për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit të parashikuara në dispozitat e kësaj rregulloreje.
6. Subjektet hartojnë dhe miratojnë rregullore/procedura për kategorizimin e klientëve dhe transaksioneve sipas shkallës së rrezikut që ato paraqesin, në përputhje me nenet 8 dhe 9 të Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave.
7. Degët dhe agjencitë e subjekteve që veprojnë në Republikën e Shqipërisë regjistrojnë transaksionet e çdo klienti për shumat e përcaktuara në këtë rregullore dhe në ligjin për parandalimin e pastrimit të parave. Organi drejtues i subjektit ruan dhe mban të gjitha raportimet e bëra nga degët dhe agjencitë e subjektit, si dhe të dhëna të përmbledhura për të gjithë rrjetin e saj në Shqipëri.
8. Subjektet sigurohen se filialet apo degët jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe në veçanti në vendet dhe territoret të cilat nuk zbatojnë apo zbatojnë pjesërisht standardet ndërkombëtare, veprojnë në përputhje me masat parandaluese të parashikuara në ligjin për parandalimin e pastrimit të parave. Nëse ligjet e vendit ku janë vendosur filialet apo degët parashikojnë pengesa për zbatimin e detyrimeve, subjekti duhet të raportojë për këto pengesa tek autoriteti përgjegjës (DPPP) dhe sipas rastit dhe në autoritetin mbikëqyrës.
9. Personat përgjegjës të subjekteve, të caktuar sipas pikës 2 të këtij neni, hartojnë dhe zbatojnë një program vjetor të trajnimit të punonjësve të subjekteve, lidhur me rregulloret dhe procedurat e brendshme të miratuara për qëllim të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.
10. Personat përgjegjës të subjekteve, të caktuar sipas pikës 2 të këtij neni, informojnë periodikisht punonjësit e këtyre të fundit lidhur me ndryshimin e dispozitave ligjore në fuqi për parandalimin dhe dënimin e veprave penale të pastrimit të parave dhe

financimit të terrorizmit, si dhe për detyrimet e tyre lidhur me zbatimin e këtyre ndryshimeve.

11. Subjektet marrin masa për zbatimin e vigjilencës së zgjeruar ndaj klientit, bazuar në kreun III të Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave.
12. Subjektet kryejnë monitorime të vazhdueshme të marrëdhënieve të biznesit me klientët e tyre, për t'u siguruar se ata kanë njohuri për klientin, për objektin e veprimtarisë së tij.
13. Punonjësit e subjekteve ruajnë konfidencialitetin për procesin e raportimit lidhur me parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit dhe ndalohen të njoftojnë klientin për procedurat e verifikimit të dyshimeve dhe për raportimin e bërë tek autoriteti përgjegjës (DPPP).

Neni 9

Raportimi tek autoriteti përgjegjës (DPPPP)

1. Subjektet i raportojnë autoritetit përgjegjës sipas formularëve të raportimit dhe afateve të përcaktuara me akt nënligjor nga autoriteti përgjegjës për të gjitha transaksionet në para fizike, në një vlerë të barabartë ose më të madhe se 1 000 000 (një milion) lekë ose kundërvlerën në monedha të tjera të huaja;
2. Subjektet, kur kanë arsye të besojnë ose të dyshojnë se transaksioni i kërkuar për t'u kryer nga një klient apo një person tjetër për llogari të klientit, mund të përfshijë pastrim të produkteve të veprës penale, financim terrorizmi apo fonde që rrjedhin nga veprimtari kriminale, ia raportojnë menjëherë çështjen autoritetit përgjegjës. Në këto raste, subjektet presin deri në 48 (dyzetë e tetë) orë pas raportimit në autoritetin përgjegjës për udhëzimet e këtij të fundit, nëse duhet ta kryejnë apo jo transaksionin.
3. Subjektet i paraqesin një raport autoritetit përgjegjës, ku parashtrojnë dyshimet që kanë për rastet kur e dinë apo dyshojnë se po kryhet, është kryer apo tentohet të kryhet pastrimi i produkteve të veprës penale, financimi i terrorizmit apo fondet e përfshira rrjedhin nga veprimtari kriminale. Raportimi bëhet menjëherë dhe jo më vonë se 72 orë.

KREU III

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 10

Kërkesa mbikëqyrëse

1. Autoriteti mbikëqyrës (AMF), mbikëqyr zbatimin e dispozitave të ligjit për parandalimin e pastrimit të parave, të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij dhe kërkesave të kësaj rregulloreje.
2. Autoriteti mbikëqyrës (AMF) raporton tek autoriteti përgjegjës çdo dyshim, çdo informacion ose të dhënë që vlerëson se mund të lidhet me pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit, të cilat i konstaton gjatë procesit të mbikëqyrjes.
3. Autoriteti mbikëqyrës (AMF) vlerëson mjaftueshmërinë e programeve dhe të sistemit të kontrollit të brendshëm të subjektit, në funksion të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

4. Autoriteti mbikëqyrës (AMF) për të gjitha shkeljet e evidentuara të cilat mund të klasifikohen si kundravajtje administrative, në bazë të nenit 27 të Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave, dhe germës b), pika 3 e Ligjit nr. 157, datë 10.10.2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit, informon autoritetin përgjegjës duke i vënë në dispozicion dokumentacionin e plotë që ka lidhje me konstatimin e shkelje dhe bashkëpunon me të.
5. Autoriteti mbikëqyrës (AMF) mund të kërkojë nga subjektet akses dhe vënien në dispozicion të çdo lloj informacioni dhe dokumenti që lidhet me përputhshmërinë e detyrimeve të subjekteve në zbatim të Ligjit për parandalimin e pastrimit të parave.

Neni 11 **Dispozita të tjera**

Subjektet e kësaj rregulloreje, jo më vonë se 3 (tre) muaj pas hyrjes në fuqi të saj, janë të detyruara të kryejnë në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje rishikimin dhe/ose miratimin, e rregulloreve dhe procedurave të brendshme për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit.

Subjektet raportojnë pranë Autoritetit mbi baza vjetore të dhënat e kërkuara sipas Anekseve 4 dhe 5, bashkëngjitur kësaj rregulloreje, brenda 30 ditëve pas mbylljes së vitit kalendarik.

Subjektet e kësaj rregulloreje raportojnë të dhënat për vitin 2017 sipas anekseve 4 dhe 5 brenda datës 30 prill 2018.

Neni 12 **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

ANEKS I

UDHËZIME SPECIFIKE PËR TREGUN E SIGURIMEVE DHE LETRAVE ME VLERË

A. Klasifikimi i klientëve sipas rrezikut që paraqesin

1. Klasifikimi i klientëve sipas rrezikut bëhet duke u bazuar mbi mundësinë që subjekti të përdoret nga klienti me qëllimin e pastrimit të parave dhe/ose financimit të terrorizmit, ose që klienti të përdorë biznesin e tij ligjor me qëllim që të përziejë paratë e paligjshme me të ardhurat e ligjshme.
2. Subjektet ndërmarrin masa shtesë për ato klientë të klasifikuar me rrezik të lartë. Natyra dhe tërësia e masave të marra, varet nga rrethana të caktuara konkrete (për shembull, nëse një klient është vlerësuar me rrezik të lartë për shkak të strukturës së pronësisë së tij, subjektet duhet të përfshijnë një dispozitë në procedurat e tyre, që të përcaktojë nevojën e marrjes së të dhënave shtesë dhe verifikimin e mëtejshëm të dokumenteve të paraqitura).
3. Disa kategori klientësh, që përfshijnë klientë me rrezik të lartë, përcaktohen në listën e mëposhtme, e cila nuk është kufizuese dhe nuk zëvendëson ndonjë detyrim ligjor lidhur me raportimin e klientëve që dyshohen se kryejnë transaksione të dyshimta.

Kategori të klientëve veprimtaritë e të cilëve mund të jene tregues i nivelit të rrezikut më të lartë, listohen si më poshtë:

- a. Klientë që kryejnë marrëdhënien e tyre të biznesit në rrethana të pazakonta të tilla si:
 - Distanca e konsiderueshme dhe e pashpjegueshme gjeografike midis subjektit dhe vendndodhjes së klientit;
 - Klientë të cilët kanë një strukturë, natyrë apo marrëdhënie biznesi komplekse, që e bën të vështirë identifikimin e pronarit të vërtetë dhe strukturave kontrolluese.
- b. Personat e ekspozuar politikisht (PEP);
- c. Organizatat jofitimprurëse (OJF);
- d. Transaksione me klientët jorezidentë;
- e. Marrëdhënie biznesi dhe transaksione me klientë, të cilët banojnë ose e ushtrojnë veprimtarinë në vende që nuk zbatojnë ose që zbatojnë pjesërisht standardet ndërkombëtare të PPP/LFT;
- f. Struktura e pronësisë së kompanisë duket e pazakontë ose tepër komplekse, duke pasur parasysh natyrën e biznesit të kompanisë;

- g. Transaksione në emër të një personi tjetër;
- h. Klientë që kryejnë veprimtari të biznesit që karakterizohen nga një qarkullim i madh i parasë dhe pagesave *cash*, në nivele të konsiderueshme, të tilla si: restorante, pika karburanti, zyrat e këmbimit valutor, kazino, dyqanet e lavazhit të makinave, dyqanet e luleve, tregtarët e mallrave me vlerë të lartë (metale të çmuar, gurë të çmuar, automjete, objekte arti, etj.), transportuesit e mallrave dhe të pasagjerëve, kompani bastesh sportive;
- i. Krijimi i shpeshtë dhe i papritur i marrëdhënieve të ngjashme të biznesit, pa marrë parasysh vlerësimet ekonomike si p.sh hyrja në disa marrëveshje të anëtarësimit në fondet vullnetare të pensioneve brenda një periudhe të shkurtër kohe (me një ose më shumë shoqëri administrimi);
- j. Tregtarët dhe prodhuesit e armëve;
- k. Përfaqësuesit e palëve, biznesi i të cilëve përfshin përfaqësimin (avokatët, kontabilistët ose përfaqësues të tjerë profesionalë), veçanërisht kur subjekti është në kontakt vetëm me përfaqësuesit;
- l. Kompanitë e ndërtimit;
- m. Kompanitë me një numër të vogël punonjësish që nuk janë në proporcion të drejtë me fushën e tyre të biznesit, kompanitë pa infrastrukturë ose pa mjedise biznesi, etj.;
- n. Personat të cilëve iu është refuzuar oferta e biznesit nga një tjetër subjekt, pavarësisht nga mënyra si është marrë një informacion i tillë, dhe / ose personat me reputacion jo të mirë;
- o. Klientë të cilët kanë fonde nga burime të paqarta ose të paidentifikuara, dhe / ose klientë me fonde nga burime të paverifikueshme;
- p. Klientët e dyshuar që nuk veprojnë për llogari të tyre dhe / ose që zbatojnë udhëzimet e një personi të tretë;
- q. *Trustet* dhe shoqëritë që kanë aksione të mbajtësit/shoqëritë që merren me import/eksport;
- r. Nëpunës në nivel të lartë administrimi.
- s. Natyra e konsumatorit për policat e sigurimit të jetës p.sh.:
 - Personat juridikë, struktura e të cilëve e vështirëson identifikimin e pronarit përfitues;
 - Klienti ose pronari përfitues i konsumatorit është PEP;
 - Përfituesi i policës ose pronari përfitues i këtij përfituesi është PEP;
 - Mosha e konsumatorit është e pazakontë për llojin e produktit të kërkuar (p.sh. konsumatori është shumë i ri ose shumë i vjetër);
 - Kontrata nuk përputhet me situatën e pasurisë së klientit;
 - Profesioni ose aktivitetet e klientit dyshohet të jetë e lidhur me pastrimin e parave, për shembull për shkak se ato rezulton të jenë shuma të mëdha të hollash ose shuma intensive ndaj një rreziku të lartë korrupsioni;
 - Mbajtësi i policës dhe / ose përfituesi i kontratës janë kompani me aksionarë të emëruar dhe / ose aksione në formularin e bartësit.

Subjektet, pasi kanë kryer identifikimin dhe verifikimin e klientit/ pronarit përfitues (vendosjes së marrëdhënies së biznesit), strukturat përgjegjëse, klasifikojnë klientin në kategorinë e duhur në bazë të profilit të tij, si dhe përcaktojnë nivelin e rrezikut. Subjekti është i detyruar të kryejë këtë proces edhe për klientët ekzistues. Në këtë Rregullore,

janë përcaktuar vetëm kategoritë të cilat klasifikohen si kategori me rrezik të lartë. Subjektet, krahas kategorive të përcaktuara në këtë rregullore, përcaktojnë kategori të tjera marrëdhëniesh biznesi, klientësh dhe transaksionesh, të vlerësuara me rrezik të lartë dhe ndaj të cilëve duhet të zbatohen masat e vigjilencës së zgjeruar. Të gjitha kategoritë të cilat nuk përfshihen në nivelin me rrezik të lartë, kategorizohen në nivelin e rrezikut të ulët dhe të mesëm ose të moderuar.

B. Tregues të dyshimtë që lidhen me klientin:

- a. Klienti refuzon ose nuk jep lehtë informacionin e kërkuar ose jep informacion të rremë ose ndryshon informacion shpesh dhe pa ndonjë justifikim të qartë;
- b. Klienti jep informacion përgjithësisht të ndryshëm nga ai i dhënë nga burime të pavarura, si për shembull informacion i marrë nga arkivat, listat dhe regjistrat ose të dhëna të publikuara në faqet zyrtare të internetit ë të autoriteteve kombëtare dhe ndërkombëtare;
- c. Klienti, nisur nga kërkesa e institucionit financiar për informacion të mëtejshëm, zgjedh që të mos kryejë transaksionin, ose të mos vendosë marrëdhënie biznesi apo të kërkojë ndërprerjen e marrëdhënies ekzistuese;
- d. Klienti shmang kontaktet drejtpërsëdrejti me institucionin financiar, duke autorizuar dhe dhënë fuqi veprimi në mënyrë të shpeshtë dhe jo konsistente me aktivitetin që kryen;
- e. Klienti i drejtohet një institucioni financiar ose një dege të tij, që është larg zonës së tij të rezidencës ose në të cilën kryen aktivitetin dhe ndryshon shpesh degën që përdor;
- f. Klienti tregon se nuk ka njohuri të përshtatshme mbi natyrën, objektin, shumën apo qëllimin e transaksionit apo marrëdhënies, ose jep shpjegime jo realiste, konfuze ose jo konsistente, të cilat të bëjnë të dyshosh se mund të jetë duke vepruar për një person të tretë;
- g. Klientët të cilët janë shtetas të huaj, veçanërisht persona të ekspozuar politikisht, përdorin marrëdhënien e vendosur në Shqipëri, ekskluzivisht për transferta në hyrje ose në dalje, pa justifikime ekonomike, edhe pse këto transaksione mund të kryhen në vendin e klientit me kosto më të ulët dhe në një kohë më të shkurtër;
- h. Klienti ka rezidencën, ose kryen transaksione me palë të cilat janë të vendosura në vende ose territore me rrezik të lartë dhe kryejnë transaksione të mëdha me procedura të pazakonta, pa justifikime të qenësishme;
- i. Klienti nuk paraqet detaje në lidhje me palët e treta për të cilat po vepron;
- j. Klienti kryen transaksione të shpeshta dhe të mëdha, të cilat nuk janë konsistente me profilin e tij ekonomik apo të transaksionit;

k. Klienti përfiton transferta në llogarinë e tij nga palë të treta të ndryshme, të cilat nuk janë të justifikuara nga natyra e biznesit të tij.

l. Në lidhje me kontratën, për shembull:

- Klienti shpesh e transferon kontratën tek një sigurues tjetër;
- Dorëzime të shpeshta dhe të pashpjegueshme, veçanërisht kur rimbursimi bëhet në llogaritë e ndryshme bankare;
- Konsumatori krijon një kosto të lartë duke kërkuar ndërprerjen e hershme të një produkti;
- Klienti transferon kontratën tek një palë e tretë që duket e palidhur;
- Kërkesa e konsumatorit për të ndryshuar ose rritur shumën e siguruar dhe/ose pagesën e primit janë të pazakonta ose të tepruara.

m. Në lidhje me përfituesit, për shembull:

- Siguruesi informohet për një ndryshim në përfitues vetëm kur kërkesa është bërë;
- Klienti ndryshon klauzolën e përfituesit dhe emëron një palë të tretë pa dyshim;
- Siguruesi, klienti, pronari përfitues, përfituesi ose pronari përfitues i përfituesit janë në juridiksione të ndryshme.

n. Në lidhje me pagesat, për shembull:

- Klienti përdor metoda të pazakonta të pagesave, të tilla si para të gatshme ose instrumenta të strukturuar monetarë ose forma të tjera të automjeteve të pagesave që mbrojnë anonimitetin;
- Pagesat nga llogari të ndryshme bankare pa shpjegim;
- Pagesat nga bankat të cilat nuk janë të themeluara në vendin e banimit të klientit;
- Klienti bën pagesa të shpeshta ose me vlerë të lartë, ku kjo nuk pritej;
- Pagesat e marra nga palët e treta të palidhura;
- Kontributin e kapur në një plan të daljes në pension afër datës së daljes në pension.

ANEKS II

UDHËZIME SPECIFIKE PËR FONDET E INVESTIMEVE DHE PENSIONEVE VULLNETARE

1. Fondet e Investimeve Kolektive dhe Pensioneve Vullnetare

Ky aneks, u drejtohet sipërmarrjeve të investimeve kolektive, sipas nenit 3, pika 1, të Ligjit nr.10198, datë 10.12.2009 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive” si dhe fondeve të pensioneve vullnetare.

Fondet e investimeve mund të përdoren nga persona ose subjekte për qëllime PP/FT.

Faktorët e rrezikut të produktit, shërbimit ose transaksionit që mund të kontribuojnë në rritjen e rrezikut të lidhur me fondin, janë:

- Fondi projektohet për një numër të kufizuar individësh ose biznese familjare, për shembull një fond privat ose një fond investitorësh;
 - Ekzistenca e mundësisë për tu regjistruar në fond dhe shlyerja e shpejtë e investimin pa paguar shpenzime të konsiderueshme administrative;
 - Njësitë ose aksionet e fondit mund të tregtohen pa fondin ose menaxherin e fondit që njoftohet në kohën e tregtisë dhe si rezultat i kësaj, informacioni rreth investitorit ndahet në disa subjekte (siç është rasti me fondet e mbyllura që tregtohen në tregjet dytësore);
 - Abonimi përfshin llogari ose palë të treta në juridiksione të shumta, veçanërisht kur këto juridiksione lidhen me një rrezik të lartë PP/FT;
 - Abonimi përfshin abonentë ose pagues të palëve të treta, veçanërisht kur kjo është e papritur.
- Faktorët e mëposhtëm mund të kontribuojnë në uljen e rrezikut të lidhur me fondin:
 - Pagesat e palëve të treta nuk lejohen;
 - Fondi është i hapur vetëm për investitorët e vegjël, me investime të mbuluara.
 - Faktorët që paraqesin rrezik më të lartë janë:
 - Shërbimet që paraqesin më shumë anonimitet; dhe
 - Aftësia për të bashkuar klientët themelorë/fondet.

Faktorët e rrezikut të klientit që mund të kontribuojnë në rritjen e rrezikut:

- Sjellja e klientit është e pazakontë, për shembull:
 - i. Arsyetimi për investimin nuk ka një strategji të qartë ose qëllim ekonomik ose klienti bën investime që nuk janë në përputhje me gjendjen e përgjithshme financiare të klientit, ku kjo është e njohur për fondin ose menaxherin e fondit;
 - ii. Konsumatori kërkon të riblejë ose shlyej një investim brenda një periudhe të shkurtër pas investimit fillestar ose para datës së pagimit pa një arsyetim të qartë,

- në veçanti kur kjo rezulton me humbje financiare ose pagesa të tarifave të larta të transaksionit;
- iii. Konsumatori kërkon blerjen e përsëritur dhe shitjen e aksioneve brenda një periudhe të shkurtër kohore pa një strategji të qartë ose arsyetim ekonomik;
 - iv. Konsumatori transferon fonde që tejkalojnë ato të kërkuara për investim dhe kërkon që shumat e tepërta të rimbursohen;
 - v. Konsumatori përdor llogari të shumëfishta pa njoftim paraprak, sidomos kur këto llogari mbahen në juridiksione ose juridiksione të shumëfishta të lidhura me rrezik më të lartë PP/FT;
 - vi. Konsumatori dëshiron të strukturojë marrëdhënien në mënyrë të tillë që palët e shumta, p.sh. kompanitë e emëruara të parregulluara, të përdoren në juridiksione të ndryshme, veçanërisht kur këto juridiksione lidhen me rrezik më të lartë PP/FT;
 - vii. Klienti ndryshon papritur vendndodhjen e vendbanimit pa arsyetim, për shembull duke ndryshuar vendin e banimit të klientit;
 - viii. Konsumatori dhe pronari përfitues janë të vendosur në juridiksione të ndryshme dhe të paktën një nga këto juridiksione është e lidhur me rrezik më të lartë PP/FT siç përcaktohet në pjesën e përgjithshme të udhëzimeve;
 - ix. Fondet e pronarit përfitues janë gjeneruar në një juridiksion që lidhet me rrezikun më të lartë PP/FT, veçanërisht kur juridiksioni është i lidhur me nivele më të larta të shkeljeve paragjyquese ndaj PP/FT;
 - x. Krijimi i shpeshtë dhe i papritur i marrëdhënieve të ngjashme të biznesit, pa marrë parasysh vlerësimet ekonomike si p.sh hyrja në disa marrëveshje të anëtarësimit në fondet vullnetare të pensioneve brenda një periudhe të shkurtër kohe (me një ose më shumë shoqëri administrimi).

Faktorët e rrezikut të kanaleve të shpërndarjes që mund mund të kontribuojnë në rritjen e rrezikut janë:

- Kanale të paqarta ose komplekse të shpërndarjes që kufizojnë mbikëqyrjen e fondeve të marrëdhënieve të saj të biznesit dhe kufizojnë aftësinë e saj për të monitoruar transaksionet, për shembull fondi përdor një numër të madh të nën-shpërndarësve për shpërndarje në vendet e treta;
- Distributori ndodhet në një juridiksion që lidhet me rrezikun më të lartë PP/FT siç përcaktohet në pjesën e përgjithshme të këtyre udhëzimeve.

Faktorët e vendit apo faktorët gjeografikë, që mund të kontribuojnë në rritjen e rrezikut:

- Paratë e investitorëve janë gjeneruar në juridiksione të lidhura me rrezikun më të lartë PP/FT, veçanërisht ato që lidhen me nivelet më të larta të shkeljeve parazgjedhore ndaj pastrimit të parave;
- Fondi ose Menaxheri i fondit investon në sektorë me rrezik më të lartë korrupsioni (p.sh. industritë nxjerrëse ose tregtinë e armëve) në juridiksione të identifikuar nga burime të besueshme se kanë nivele të konsiderueshme të korrupsionit ose shkelje të

tjera parazgjedhore ndaj PP/FT, veçanërisht kur fondi është një fond investitorësh të vetëm ose ka një numër të kufizuar investitorësh.

Masat

Masat që fondet ose menaxherët e fondeve duhet të marrin për të përmbushur detyrimet e tyre të CDD do të varen nga mënyra se si klienti ose investitori (ku investitori nuk është konsumatori) vjen në fond. Fondi ose menaxheri i fondeve duhet gjithashtu të marrin masa të ndjeshme ndaj rrezikut për të identifikuar dhe verifikuar identitetin e personave fizikë, nëse ka, të cilët në fund të fundit posedojnë ose kontrollojnë konsumatorin (ose në emër të të cilit transaksioni është duke u kryer), për shembull duke pyetur investitori i ardhshëm për të deklaruar, kur ata aplikojnë për t'u bashkuar me fondin, nëse investojnë në emër të tyre ose nëse janë një ndërmjetës që investon në emër të dikujt tjetër.

Konsumatori është:

- a. Një person fizik ose juridik i cili drejtpërdrejt blen njësi ose aksione në një fond për llogari të tyre dhe jo në emër të investitorëve të tjerë themelorë; ose
- b. Një firmë që, si pjesë e veprimtarisë së saj ekonomike, blen drejtpërdrejt njësi ose aksione në emër të vet dhe ushtron kontroll mbi investimin për përfitimin përfundimtar të një ose më shumë palëve të treta që nuk kontrollojnë vendimet për investime ose investime; ose
- c. Një firmë, për shembull një ndërmjetës financiar, që vepron në emër të vet dhe është pronar i regjistruar i aksioneve ose njësive, por vepron në llogari të dhe në bazë të udhëzimeve specifike nga një ose më shumë palë të treta (p.sh. ndërmjetësi financiar është një ndërmjetës i emëruar, broker, llogari me shumë klientë të përbërë nga llogaritë / operatori i llogarisë së tipit omnibus ose operatori i një marrëveshjeje të ngjashme të tipit pasiv); ose
- d. Klienti i një firme, për shembull klienti i një ndërmjetësi financiar, ku firma nuk është pronar i regjistruar i aksioneve ose njësive (p.sh. sepse fondi i investimit përdor një ndërmjetës financiar për shpërndarjen e aksioneve ose njësive të fondit dhe investitori blen njësi ose aksione nëpërmjet firmës dhe firmës nuk bëhet pronari ligjor i njësive apo aksioneve).

Vigjilenca e zgjeruar

Masat e vigjilencës së zgjeruar që mund të jenë të përshtatshme në situatat me rrezik të lartë, përfshijnë:

- Marrjen e informatave shtesë të klientit, të tilla si reputacioni dhe sfondi i klientit, përpara krijimit të marrëdhënies afariste;
- Marrjen e hapave shtesë për të verifikuar më tej dokumentet, të dhënat ose informatat e marra;
- Marrjen e informacionit mbi burimin e fondeve dhe / ose pasurinë burimore të klientit dhe të pronarit përfitues të klientit;

- Kërkuar që pagesa e shlyerjes të bëhet nëpërmjet llogarisë fillestare të përdorur për investim ose një llogari në emër të vetëm ose të përbashkët të klientit;
- Rritja e frekuencës dhe intensitetit të monitorimit të transaksioneve;
- Detyrimin që pagesa e parë të bëhet përmes një llogarie pagese të mbajtur në emër të vetëm ose të përbashkët të klientit me një institucion kreditimi apo institucioni financiar të rregulluar në një vend të tretë që zbatojnë plotësisht standardet ndërkombëtare të PPP/LFT;
- Marrjen e miratimit nga menaxhmenti i lartë në kohën e transaksionit kur një klient përdor një produkt ose shërbim për herë të parë;
- Monitorimin e zgjeruar të marrëdhënies me klientët dhe transaksionet individuale;
- Ndërmjetësi financiar i nënshtrohet detyrimeve PPP/LFT në një juridiksion të ZEE ose në një vend të tretë që ka kërkesa PPP/LFT që zbatojnë standardet ndërkombëtare të PPP/LFT;
- Ndërmjetësi financiar mbikëqyret në mënyrë efektive për përmbushjen e këtyre kërkesave.

A. Klasifikimi i transaksioneve sipas rrezikut që paraqesin

Klasifikimi sipas rrezikut bëhet duke gjykuar mbi mundësinë që transaksioni të përdoret nga klienti, me qëllimin e pastrimit të parave dhe/ose financimit të terrorizmit, ose me qëllim që të përziejë paratë e paligjshme me të ardhurat e ligjshme.

Subjektet, si një pjesë normale të zhvillimit të aktivitetit të tyre, monitorojnë elementet ose transaksionet individuale të cilat mund të tregojnë fonde të përfshira në procesin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit.

Kategoritë të cilat paraqesin një nivel të lartë rreziku janë:

- a. Shërbimet e identifikuar nga ana e autoriteteve kompetente ose burime të tjera të besueshme si potencialisht me rrezik të lartë:
 - Transaksionet komplekse, me vlera të larta dhe të pazakonta, të cilat nuk kanë qëllim të dukshëm ekonomik ose ligjor;
 - Transaksione nëpërmjet zhvillimeve të reja teknologjike.
- b. Shërbime të reja në treg, pra shërbime që nuk janë ofruar më parë në sektorin financiar, të cilat duhet të monitorohen posaçërisht në mënyrë që të përcaktohet shkalla reale e rrezikut që shoqëron ato (shërbimet);
- c. Dorëzimi elektronik i urdhrave të tregtimit të titujve, në rastet e parashikuara nga subjekti në procedurat e tij;
- d. Përdorimi i teknologjive moderne që ofrojnë anonimitet (internet, mobile).

B. Tregues të dyshimeve që lidhen me transaksionet:

Treguesit e mëposhtëm të dyshimeve të mundshme ose të aktiviteteve jo të zakonta përcaktojnë disa lloje transaksionesh që mund të përbëjnë arsye për monitorim të mëtejshëm. Kjo listë nuk është kufizuese dhe nuk zëvendëson ndonjë detyrim ligjor lidhur me raportimin e transaksioneve të dyshimta ose të pazakonta. Lista e mëposhtme përmbledh një numër transaksionesh që duhet të trajtohen me kujdes nga subjektet si transaksione të dyshimta.

1. Tregues të transaksioneve të dyshimta

- a. Kërkesa për transaksione të cilat kryhen pa marrë parasysh vlerësimin për rrezikun e investimit, komisionet e vendosura ose kosto të tjera.
- b. Urdhra të përsëritura për transaksione nga kompani që rezultojnë rregullisht me humbje ose në vështirësi financiare, të cilat vazhdojnë të kenë të njëjtin administrim pavarësisht ndryshimeve të herëpashershme të pronarëve.
- c. Marrje të shpeshta të fondeve nga subjekte të ndryshme, të shoqëruara me transferta të urdhëruara nga klientë në lidhje me llogari të cilat janë pronë e trusteeve.
- d. Transaksione të mëdha në mënyrë të përsëritur me palë, të cilat janë kompani të sapokrijtura dhe që kanë objekt të veprimtarisë së tyre, veprimtari që nuk përputhet me aktivitetin e klientit ose që kanë qëllim të përgjithshëm.
- e. Transaksione të pazakonta me praktikatat aktuale të tregut ose që ndikohen nga procedura dhe instrumente veçanërisht të ndryshëm nga ato të operatorëve të tjerë aktivë në atë fushë, veçanërisht nëse janë shumë komplekse ose kanë të bëjnë me transferta të shumave të mëdha, që nuk justifikohen nga nevoja të caktuara.
- f. Fonde nga jashtë, në shuma të mëdha dhe të shpeshta në drejtim të llogarive ose marrëdhënieve të vendosura në Shqipëri nga kompani që kanë pronar persona me qendër në vende me rrezik të lartë ose që tregojnë transaksione jo tipike të biznesit apo aktivitetit dhe që shoqërohen nga tërheqje të mëdha cash nga këto vende.
- g. Transaksione që nuk përputhen me instrumentet e përdorur me aktivitetin ekonomik ose profilin ekonomik apo financiar ose në rast të personave juridikë, apo të një grupi, këto transaksione nuk janë të justifikuara si duhet nga klienti.
- h. Përdorimi i llogarive të shoqërive ose ndërmarrjeve nga ana e aksionarëve, drejtorëve ose punonjësve për transaksione të cilat nuk janë pjesë e biznesit të shoqërive/ndërmarrjeve, veçanërisht transaksione në cash ose për shuma të mëdha.
- i. Përdorimi i llogarive në emër të individëve (aksionarëve, drejtorëve, punonjësve ose klientëve apo të afërmve të tyre) për transaksione në interes të shoqërisë ose ndërmarrjes, veçanërisht transaksione në cash ose për shuma të mëdha.

- j. Transaksione të mëdha nga persona të cilët nuk merren me aktivitet ekonomik ose janë në vështirësi ekonomike.
- k. Transaksione të shpeshta ose të mëdha nga klientë në emër ose në favor të personave të tretë ose nga persona të tretë në emër apo në favor të një klienti, kur marrëdhëniet personale, tregtare ose financiare midis palëve janë të pashpjegueshme, veçanërisht nëse këto transaksione duket se janë ndërtuar për të mos stimuluar një lidhje me transaksionet e tjera.
- l. Transaksione të autorizuar nga një ose më shumë persona me prokurë, karakteristikat dhe qëllimet e të cilëve nuk lidhen me aktivitetin ekonomik të klientit.
- m. Transaksione të përsëritura, veçanërisht për shuma të konsiderueshme, të autorizuar në lidhje me marrëdhënie ku janë të përfshirë të mitur, persona në moshë ose me aftësi të kufizuar.

2. Transaksionet në instrumentet financiare

- a. Transaksionet nëpërmjet përdorimit të instrumenteve financiare që nuk përputhen me profilin financiar dhe ekonomik të klientit ose të cilat kryhen nëpërmjet procedurave jo të zakonshme, veçanërisht për shuma të mëdha parash të pajustificuara nga procedura të veçanta.
- b. Blerja e instrumenteve financiare (veçanërisht të njësive të investimeve të pronave të paluajtshme) me çmime dukshëm më të larta se ato të tregut.
- c. Transaksione të shpeshta në instrumente financiare, duke përfshirë ndarje transaksionesh, për shuma të mëdha që shlyhen në cash ose që nuk kalojnë në llogarinë apo nëpërmjet marrëdhënies së klientit.
- d. Investime të shpeshta dhe të mëdha në instrumente financiare, të cilat paguhen nga subjekte/ndërmjetës që ndodhen në vende me rrezik të lartë.
- e. Investime të shpeshta afatgjata në instrumente financiare që ndiqen nga kërkesa të menjëhershme për likuidimin e pozicionit dhe transferimin e të ardhurave.
- f. Blerja në një masë të konsiderueshme e një instrumenti financiar shumë likuid që ndiqet nga kërkesa për kredi të garantuar nga këto instrumente.
- g. Blerje dhe shitje të herëpashershme të instrumenteve financiare, nga dy ose më tepër persona, veprim i cili nënkupton një bashkëpunim në transferimin e fondeve, veçanërisht nëse transaksionet kryhen me çmime të ndryshme nga ato të tregut dhe që fillojnë dhe përfundojnë në kohë të shkurtër dhe përshtijnë instrumente që tregtohen pak.

- h. Transaksione me instrumente financiare që karakterizohen nga regjistrimi në emër të personave të tretë ose nga ndërhyrja e personave, të cilët nuk janë të justifikuar në ndonjë mënyrë nga marrëdhënia ndërmjet palëve.
- i. Klienti ka për qëllim të blejë tituj të tregtueshëm normalisht në treg dhe refuzon të plotësojë kriteret e identifikimit si dhe të paraqesë dokumentet e duhura të verifikimit.
- j. Blerja e sasive të mëdha të instrumenteve financiare me kërkesa për regjistrim në emër të personave të tretë të lidhur ose jo.
- k. Transaksione të shumta dhe të shpeshta që lidhen me marrjen dhe shlyerjen e instrumenteve financiare, të cilat i përkasin personave të ndryshëm dhe që shlyhen në të njëjtën llogari në emër të një trusti.
- l. Blerje të shpeshta dhe të mëdha të instrumenteve financiare të kryera në emër dhe për llogari të rezidentëve të vendeve me rrezik të lartë.
- m. Blerje të shpeshta dhe të mëdha që lidhen me instrumente financiare të pa materializuara, sidomos me instrumente titujsh, në mungesë të një justifikimi të pranueshëm.
- n. Blerja e instrumenteve financiare të pamaterializuar të shoqëruar në të njëjtën kohë me kërkesën për dërgesë fizike ose për transferim tek palë të treta jashtë vendit.
- o. Paraqitja e instrumenteve financiare të pamaterializuara për t'u kthyer në cash ose për blerjen e instrumenteve të tjera pa kryer transaksionin nëpërmjet llogarisë së klientit ose paraqitja e tyre për t'u depozituar me kërkesën për të dhënë një faturë.
- p. Klienti paraqet vështirësi për të sjelle dokumentacionin e nevojshëm për të përcaktuar profilin e tij ekonomik ose të transaksionit.
- q. Një përfaqësues i shoqërisë, i cili përpiqet të përfundojë një marrëveshje në emër të shoqërisë, refuzon të japë informacion ose jep informacion të pamjaftueshëm në lidhje me natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të shoqërisë, selinë, pronësinë ose kontrollin, identitetin e personave fizikë që janë përfituesit realë, vëllimit të pritshëm të aktivitetit në llogari ose informacion tjetër të kërkuar ose edhe pse i kërkohet nga institucioni financiar, refuzon të pajisë këtë të fundit me dokumentacionin verifikues.
- r. Transferta të shpeshta të aksioneve të shoqërive off-shore ose kompanive që emetojnë aksione, të cilat janë pronarë të paidentifikueshëm dhe që çojnë në pamundësinë për të identifikuar pronarin përfitues.
- s. Aktivizimi i papritur i një biznesi joaktiv, veçanërisht në rastet e kompanive off-shore ose kompanive që emetojnë aksione, të cilat kanë pronarë të paidentifikueshëm (bearer shares).

3. Tregues të anomalisë në transaksionet me jashtë

- a. Transaksione me filiale ose me degë të institucioneve financiare, të rrethuara nga zona gjeografike të njohura si zona të trafikut të drogës ose si “qendra offshore”, që nuk janë të justifikuar nga aktiviteti ekonomik që kryhet nga klienti.
- b. Përdorimi i sistemeve të tjera të financimit tregtar për të transferuar shuma midis shteteve, pa qenë transaksioni përkatës i justifikuar nga veprimtaria e zakonshme ekonomike e kryer nga klienti.
- c. Kryerje e disa transfertave në një drejtim të caktuar, transfertat të ndryshme që kanë një përfitues, pavarësisht nga shuma.

4. Tregues anomalie në sjelljen e klientëve

- a. Klientë që kërkojnë të ristrukturojnë transaksionin, kur konfiguracioni i paraqitur që në fillim përfshin forma identifikimi e regjistrimi ose plotësime hetimesh apo verifikimesh nga ana e personelit të ndërmjetësuesit, ose adoptimi i klauzolave kufizuese të lirisë së qarkullimit të titujve (për shembull, reduktimi i vleftës së transaksionit nën kufijtë e përcaktuar për të shmangur identifikimin).
- b. Klientë që refuzojnë ose që pa justifikim të arsyeshëm hezitojnë të japin informacionet e duhura për kryerjen e transaksioneve, të deklarojnë aktivitetet e veta, të paraqesin dokumentacionin kontabël ose të një lloji tjetër, të sinjalizojnë marrëdhëniet e mbajtura me subjektet e tjera, të japin informacione, të cilat në rrethana normale do ta bënin vetë klientin të përshtatshëm për të marrë kredinë ose shërbime të tjera bankare/financiare.
- c. Klientë në vështirësi ekonomike, që papritur kërkojnë të shlyejnë plotësisht ose pjesërisht detyrimet e veta me anë të derdhjeve të papritura me një vleftë të madhe, pa një justifikim të dukshëm dhe pa saktësuar origjinën e fondeve.
- d. Klientë që evitojnë kontakte direkte me personelin e subjektit, duke lëshuar prokura në emër të të tretëve, në mënyrë të shpeshtë e të pajustificuar.
- e. Klientë që, pa dhënë justifikime të arsyeshme, drejtohen tek një sportel subjekti, që ndodhet larg nga zona në të cilën banojnë ose ushtrojnë aktivitetin e tyre.
- f. Klientë ose përfaqësues të tyre që paraqesin dokumente identifikimi me origjinë të dyshimtë.
- g. Klientë që japin si adresë të tyre një adresë të një personi të tretë.
- h. Klientë që hapin disa llogari dhe kryejnë transfertat të shpeshta të fondeve midis tyre.
- i. Klientë që kryejnë transaksione me partnerë jo të zakonshëm.

- j. Mosjustifikimi me dokumentacion përkatës i veprimeve të kryera nga jorezidentët me llogaritë e hapura pranë subjekteve.

5. Tregues anomalie të karakteristikave të klientit ose të biznesit të tij

- a. Fondet e krijuara nga një biznes që zotërohet nga individë të të njëjtit vend origjine ose përfshirja e shumë individëve të së njëjtës origjinë nga vende që paraqesin problem/shqetësim specifik duke vepruar në interes të llojeve të ngjashme të bizneseve.
- b. Adresë e përdorur bashkërisht për individë të përfshirë në transaksione cash, veçanërisht kur adresa është edhe një vend biznesi dhe/ose nuk duket të korrespondojë me profesionin e deklaruar (për shembull student, i papunë, i vetëpunësuar etj.).
- c. Profesionin e deklaruar i personit që kryen transaksionin nuk është në përputhje me nivelin ose llojin e aktivitetit (për shembull, një student ose një individ i papunë i cili merr ose dërgon një numër të madh transfertash, ose i cili bën tërheqje maksimale ditore në cash në vende të ndryshme në një shtrirje gjeografike të gjerë).
- d. Për organizatat jofitimprurëse ose të bamirësisë, transaksionet financiare për të cilat nuk duket të ketë qëllim logjik ekonomik ose në të cilat nuk duket të ketë lidhje midis aktivitetit të deklaruar të organizatës dhe palës tjetër në transaksion.
- e. Mospërputhje të pashpjeguara të krijuara nga procesi i identifikimit ose verifikimit të klientit (për shembull, në lidhje me vendin e mëparshëm apo aktual të rezidencës, vendin e lëshimit të pasaportës, vendeve të vizituara sipas pasaportës, dhe dokumenteve të dhëna për të vërtetuar emrin, adresën dhe datën e lindjes).

6. Transaksione të lidhura me vende që paraqesin shqetësime / probleme

- a. Një klient merr pjesë në transaksione financiare tregtare që përfshijnë lëvizje të fondeve drejt ose nga vende me situata/gjendje/probleme të veçanta ku nuk duket të ketë arsye logjike biznesi për të vepruar me këto vende.
- b. Hapja e llogarive të institucioneve financiare nga vende me situata/gjendje/probleme të veçanta.
- c. Dërgimi ose marrja e fondeve nga transfertat ndërkombëtare nga dhe/ose për në vende me situata/gjendje/probleme të veçanta.
- d. Transaksione për subjekte të huaja në vende me parajsë bankare ose financiare, nga vende që lejojnë çeljen e llogarive anonime ose që legjislacioni i të cilave nuk konsideron dhe klasifikon si vepër penale pastrimin e parave.

7. Sjellje e dyshimtë e punonjësve

- a. Një ndryshim i madh në kushtet e jetesës së një punonjësi të institucionit financiar i pamotivuar, që shfaq menjëherë elementet e një mënyre të shtrenjtë jetese.
- b. Një punonjës që bën jetesë luksoze e cila nuk justifikohet me të ardhurat e tij.
- c. Një punonjës bisedon/krijon afrimitet me klientët më shumë se zakonisht.
- d. Një punonjës nuk preferon të marrë leje për pushime.

ANEKSI III

A. TIPOLOGJIA E PASTRIMIT TË PARAVE

1. Keqpërdorimi i sektorit të sigurimeve

Industria e Sigurimeve ofron transferim të rrezikut, kursimeve dhe investimeve një numri të madh konsumatorësh, që nga individët deri tek korporatat shumëkombëshe dhe qeveritë. Sektori i sigurimeve si çdo shërbim tjetër financiar është i ekspozuar ndaj kërcënimit se mund të shfrytëzohet nga kriminelët në përftim të tyre. Në këtë sektor mund të identifikohen dy lloje të ndryshme të sjelljes së kriminale. Kriminelët që përdorin këtë sektor për të pastruar paratë që përfitojnë nga aktivitete të paligjshme ose që mund të keq përdorin këtë sektor për të nxjerrë përfitime nëpërmjet mashtrimit.

Në sektorin e sigurimeve sigurimi i jetës paraqitet si zona më tërheqëse për pastruesit e parave. Shuma të mëdha investohen në produkte të sigurimit të jetës dhe shumë prej këtyre produkteve kanë një nivel të lartë fleksibiliteti, dhe në të njëjtën kohë i sigurojnë me norma kthimi të papërfillshme.

1.1. Tregues të rrezikut në fushën e sigurimeve

- a. Dyshimi se kontratat e sigurimit janë lidhur në emra të rremë, në emra personash të tjerë, ose me adresa të rreme.
- b. Sjellje anormale e policëmbajtësit. Ndërhyrje e pajustificuar nga palët e treta. Refuzim për të dhënë informacionin e kërkuar për veten ose transaksionin. Kërkesë pa baza për modifikimin e kushteve të kontratës nga ana e klientit. Depozitim i paparashikuar ose tërheqje e menjëhershme e tyre.
- c. Klienti pranon kushte të pafavorshme në kontratën e sigurimit që lidhen me shëndetin apo moshën e tij.
- d. Prishje e parakohshme e policës dhe mosshqetësimi i klientit për penalitetet e larta në rastin e prishjes së kësaj police. Aplikanti për sigurim biznesi nuk shfaq interes për kushtet e policës, por më shumë interes për kushtet e prishjes së kontratës.
- e. Anulimi i policave të sigurimit në një kohë shumë të shkurtër pasi kontrata është nënshkruar, duke kërkuar kthimin e parave dhe pagimin e tyre nëpërmjet palëve të treta.
- f. Shoqëritë e sigurimit paguajnë për punonjësit e tyre prime jashtëzakonisht të mëdha, ose anulojnë policat menjëherë pas nënshkrimit të kontratës së sigurimit.
- g. Shoqëritë blejnë një numër më të madh policash sigurimi për punonjësit e tyre, megjithëse numri i të punësuarve është më i vogël se numri i policave të blera, gjë që tregon se policat janë lëshuar për persona të cilët nuk janë të punësuar nga kompania.
- h. Një numër njerëzish blejnë polica sigurimi të jetës për shuma të mëdha. Pak kohë më pas policat anulohen dhe u kthehet kapitali i investuar, pasi janë zbritur penalitetet për anulimin e tyre.

- i. Fondet janë depozituar në dy llogari bankare jashtë shtetit, të cilat rezultojnë si të ardhura nga investimet e kryera jashtë shtetit.
- j. Pagesa për një policë sigurimi të jetës është bërë nëpërmjet dy transfertave bankare elektronike nga llogari jashtë shtetit.
- k. Përpyetje për të blerë polica sigurimi jete për një numër shtetasish të huaj.
- l. Shoqërisë së sigurimit i është kërkuar që të ofrojë mbulim të jetës me një vlerë dëmshpërblimi të barabartë me vleftën e primit.
- m. Në rast se policat janë anuluar, primit e kthyera janë paguar në një llogari bankare në një juridiksion të ndryshëm nga i të siguruarit.
- n. Një investim i konsiderueshëm në sigurimin e jetës me anë të një brokeri në sigurime. Pagesa është bërë në tre këste cash. Brokëri dorëzon tre çeqet e tërhequra nga llogaria e tij bankare për kompaninë e sigurimeve. Reputacioni i brokerit pengon bankën të zhvillojë hetim të thellë në marrëdhëniet e biznesit.
- o. Klienti ka për qëllim të aplikojë për një kredi duke përdorur si kolateral shumën e policës së sigurimit.
- p. Klienti dëshiron të blejë një policë sigurimi ose të bëjë një investim i cili i tejkalon dukshëm ato që ai posedon, ose pa një qëllim të qartë, apo kur burimi i fondeve me të cilat do të kryhet operacioni është i dyshimtë.
- q. Policëmbajtësi është kriminel i njohur, i afërm apo mik i një krimineli të njohur.
- r. Pagesa relativisht të larta në krahasim me pagesat mesatare që i bëhen klientëve me të njëjtin mbulim.
- s. Rritje e konsiderueshme e tavanit të pagesave për klientët për të cilët data e përfundimit të kontratës së sigurimit është shumë afër.
- t. Mbulim i përgjithshëm me sigurim për pasuri me vlerë që nuk përputhet me profilin ekonomik të klientit.
- u. Biznese jashtë kufirit në juridiksione të rrezikshme.
- v. Rritje e konsiderueshme e tavanit të pagesave për klientët për të cilët data e plotësimit të kontratës së sigurimit është shumë afër.

1.2. Raste studimi në sigurime

Një policë sigurimi që përdoret për të pastruar para

Një person që pastronte para bleu një pronë detare dhe kërkoji sigurimin për një anije fantazmë transoqeanike. Ai pagoi shuma të mëdha për policën dhe punësoi ndërmjetës që të ngriheshin pretendimet dhe të bëheshin pagesat.

Megjithatë, ai ishte shumë i kujdesshëm të siguronte që pretendimet të ishin më pak se pagesat primit kështu që siguroesi gëzonte një përfitim të kënaqshëm të policës.

Në këtë mënyrë, personi që pastron paratë është në gjendje të marrë ato që pretendon në formë çeku të cilat përdoren për të pastruar paratë. Fondet vijnë nga një kompani sigurimi me emër dhe nuk ngjallen dyshime.

Shlyerja e parakohshme e policës, sidomos në një situatë jo të favorshme ekonomike apo jashtëzakonisht të parakohshme.

Subjekti depoziton një milion Euro *cash* në një shoqëri sigurimi jete për 2 polica jete të veçanta. Shuma e depozituar tërhiqet para kohe duke shkaktuar një humbje prej 40% në investimin e kryer, si pasojë e anulimit përpara afatit të përfundimit të kontratës.

Shuma e tërhequr derdhet në llogari bankare jashtë juridiksionit për të shmangur kreditorët që kërkojnë dëmshpërblim nga subjekti i cili ka deklaruar falimentimin e kompanisë.

2. Keqpërdorimi i letrave me vlerë

Letrat me vlerë mund të përkufizohen si një instrument i negociueshëm që përfaqëson një vlerë financiare. Letrat me vlerë janë të kategorizuara në përgjithësi në letra me vlerë të borxhit dhe letra me vlerë të kapitalit neto (secili ka gamë të gjerë të produkteve). Nga natyra e tyre, letrat me vlerë mund të jenë të “certifikuara” ose “jo-certifikuara”.

1. Tregjet dhe mekanizmat në të cilat shiten dhe blihen letrat me vlerë mund të ndahen në:

- *Shkëmbime tradicionale.* -Subjekte të organizuara qendrore që operojnë publikisht si tregje shkëmbimi për letrat me vlerë;
- *Shkëmbimet me instrumente të tjerë(OTC)* -shumë letra me vlerë tregtohen në tregjet OTC dhe jo te zyrat e shkëmbimit. Tregjet OTC zakonisht i referohen tregtimit të letrave me vlerë në forma të tjera dhe jo nëpërmjet shkëmbimit;
- *Platforma të tregtimit Alternativ (PTA), Rrjetet e komunikimit Elektronik (RKE) dhe Llogaritë e Tregtimit nëpërmjet Internetit* - Gjatë tregtimit tek zyrat e shkëmbimit dhe tregjet OTC normalisht kërkohet ndërmjetësimi i letrave me vlerë, teknologji të reja lejojnë investitorët institucional dhe investitorët e tjerë të angazhohen në transaksionet e letrave me vlerë me përfshirje të kufizuar të një ndërmjetësi. Komisionerët dhe institucione të tjera të licencuara për të bërë të efektshme transaksionet e letrave me vlerë, ju ofrojnë klientëve të tyre mundësinë për të transferuar letra me vlerë që mbahen elektronikisht.

Në mënyrat e pagesës që bëhen nga transaksionet e letrave me vlerë përfshihen:

- *Cash* - përdorimi i *cash-it* në sektorin e letrave me vlerë është i pazakontë. Megjithatë, në disa vende pagesa *cash* është ende një formë e lejueshme. Veç kësaj, në disa shtete letrat me vlerë mund të blihen nëpërmjet institucioneve që ruajnë depozitat, ku dominon prania e *cash-it*;
- *Ceçet dhe transferimi me bankë* - çeçet mund të përdoren për të mbushur llogaritë e letrave me vlerë me ndërmjetësim të letrave me vlerë ose

përdoren për të blerë direkt disa produkte të letrave me vlerë pa një ndërmjetës. Veç kësaj përdorimi i çeqeve nuk është i kufizuar vetëm për ata që tërhiqen nga llogaria depozitës, por mund të përfshijë dërgesa parash, çeqe udhëtarësh dhe çeqe arkëtarësh. Megjithëse shumë transferata parash bëhen me dhe nëpërmjet bankave, në disa vende llogaritë e letrave me vlerë mund të përdoren për të transferuar fonde;

- *Shkëmbimi i letrave me vlerë si forma pagesash* - një metodë pagimi që është specifike për letrat me vlerë është përdorimi i letrave me vlerë të shkëmbehen në letra të tjera me vlerë. Kjo ndodh kur aksionet e një lloji tjetër nxirren si aksione të reja apo aksionet e reja nxirren në shitje. Shkëmbimi i aksioneve është një mënyrë për të lëvizur vlerat nga një kompani tek tjetra dhe mundësia për të fshehur origjinën e fondeve është e qartë.

Subjektet e përfshira në tregun e aksioneve (ndërmjetësit e letrave me vlerë) përfshijnë:

Komisionerët-tregtarët- janë pjesëmarrësit më aktivë në tregun e letrave me vlerë; një komisioner vepron si një agjenci për një investues dhe hyn në tregun e letrave me vlerë në emër të një investuesi për të blerë ose shitur letra me vlerë. Ata shpesh përdorin një shumëllojshmëri terminologjie si:

- Operatorët e Instrumenteve Financiare të Biznesit;
- Firmat për Vendosjen e Porosive tek Instrumentet Financiare;
- Firmat e Investimit;
- Ofruesit e Shërbimit së Investimit;
- Agjencitë Siguruese.

Këshilltarët e biznesit dhe Menaxherët e Pasurive - Roli i këshilluesve të investimit dhe menaxherëve është përgjithësisht të këshillojë mbi përbërjen e portofolit të investimeve ose të menaxhojë llogaritë e investimit për institucionet dhe klientët. Menaxhimi i pasurive në mënyrë tipike përfshin ofrimin e shërbimeve financiare për menaxhimin e marrëdhënieve me klientët që kanë vlerë të lartë neto. Vlëra dhe kompleksiteti i produkteve të ofruara për klientët me vlerë të lartë neto, së bashku me natyrën ndërkombëtare të biznesit, të bëjë sigurimin e shërbimeve të menaxhimit të pasurisë që janë potencialisht tërheqëse për pastruesit e parave.

Institucionet depozituese - Në disa juridiksione, institucionet depozituese shërbejnë gjithashtu si ndërmjetës për transaksionet në letra me vlerë ose japin këshilla për investime/shërbime të planifikimit financiar.

Kompanitë e sigurimit - Kompanitë e sigurimit nxjerrin produkte që në disa shtete konsiderohen letra me vlerë.

2.1. Transaksionet dhe teknikat që kanë lidhje me pastrimin e parave në fushën letrave me vlerë.

Tregtimi i brendshëm - I referohet informacionit të arritshëm vetëm nga njerëz të caktuar brenda një kompanie ose organizate për shkak të pozitës së tyre në të, zakonisht ky është informacionin i rëndësishëm që mund të sjellë përfitime për tregtarët e aksioneve. Edhe pse tregtimi i brendshëm është i paligjshëm, kjo nuk do të thotë se anëtarët e një kompanie apo organizate nuk mund të tregtojnë aksionet e letrave me vlerë të kompanisë. Megjithatë tregtimi i brendshëm përfshin situata ku një person ka akses në ‘informacionin sekret’, qoftë i brendshëm ose i jashtëm në kompani, apo marrëdhënie të tjera besimi. Ky person mund t’i jap edhe dikujt tjetër informacion tregtimi.

Manipulimi i tregut - I referohet sjelljes që ka si synim të mashtrorë investitorët duke kontrolluar ose ndikuar në mënyrë artificiale tregun e letrave me vlerë. Në veçanti, qëllimi i manipuluesve është të ulin ose ngrenë çmimin e letrave me vlerë për të përfituar nga diferenciali. Ka metoda të ndryshme që përdorin manipuluesit për të arritur këto rezultate. Metoda që dominon për manipulimin e tregut është ajo që referohet si skema “*pump-and-dump*” sipas të cilës informacioni i rremë dhe/ose mashtrues shpërndahet me qëllim që të krijoj një rritje dramatike të çmimit të aksioneve të dopta (*the pump*) (pompimi). Kur çmimi arrin një nivel të caktuar, kriminelët shesin menjëherë aksionet e tyre (*the dump*), duke marrë kështu fitime të konsiderueshme para se çmimi i aksioneve të bjerë sërish në nivelin e zakonshëm.

Forma të tjera të “mashtrimit të letrave me vlerë”.

- Dhomat që ziejnë (*Boilde roms*) - Në biznes, termi dhoma që ziejnë i referohet një qendre aktiviteti ku shpesh mallrat shiten nëpërmjet telefonit, me anë të metodave mashtruese dhe keqinformuese, duke ushtruar trysni mbi blerësit e mundshëm. Letrat me vlerë që shiten në dhomat që ziejnë janë aksione të mbivlerësuar ose pavlerë, aksione jo ekzistente apo të limituara, si dhe aksione të ofruara nga ndërmjetës të cilët nuk japin shumë informacion rreth tyre.
- Skemat Ponzi - është një fond investimi, ku tërheqjet janë të financuara nga ana e investitorëve të mëvonshëm, jo një fitim i marrë përmes aktiviteteve investuese. Ky lloj i skemës tenton të rrëzohet, kur numri i investimeve të reja në skemë nuk i përmbush detyrimet e pagesës për investitorët e mëparshëm.

2.2. Treguesit e rrezikut

- a. Klienti i jep firmës së letrave me vlerë dokumente të pazakontë ose të dyshimtë që nuk mund të verifikohen menjëherë ose që nuk janë në përputhje. Klienti refuzon të japë informacion më të plotë në lidhje me natyrën dhe qëllimin e biznesit të tij, nëse kërkohet, ose refuzon të identifikojë një burim legjitim për fonde ose jep informacion të rremë ose i pasaktë.

- b. Klienti ka histori me ndërrimin e këshilltarëve financiar dhe /ose përdor shumë firma dhe banka. Treguesi bëhet edhe më i fortë pasi klienti përdor firma që janë të vendosura në disa vende.
- c. Klienti ka marrëdhënie tregtare ose marrëdhënie të tjera me persona të rrezikshëm ose institucione dhe njihet publikisht pasi ka qenë në ndjekje penale për korrupsion, krime apo keqpërdorim të fondeve publike.
- d. Klienti vepron me ndërmjetës, si menaxher parash apo këshilltar, në mënyrë që të mos regjistrohet identiteti i tij.
- e. Klienti depoziton, tërheq apo blen instrumente monetarë apo financiar nën tavan në mënyrë që të shmang raportimet ose regjistrimin e të dhënave sipas kërkesave.
- f. Klienti kryen operacione biznesi të pakuptimta pavarësisht rezultatit dhe pa ndonjë qëllim të dukshëm ekonomik; aktiviteti nuk është në përputhje me objektivin apo profilin e biznesit të klientit.
- g. Transaksionet e letrave me vlerë kryhen në shumë juridiksione dhe në veçanti në juridiksione me rrezik të lartë.
- h. Përdorimi i personave apo subjekteve në vijë të parë (p.sh. korporata, truste).
- i. Transaksionet ku një palë blen letra me vlerë me çmim të lartë dhe më pas i shet me një humbje të konsiderueshme një pale tjetër. Ky mund të jetë tregues se po transferohet vlerë nga një palë tek një palë tjetër.
- j. Përdorimi i parave *cash* për të paguar dividendin e investitorëve nga një kompani.
- k. Transferimi i aseteve pa lëvizjen korresponduese të fondeve.
- l. Transaksione që tregojnë se klienti po vepron në emër të një pale të tretë.
- m. Klienti merr shumë çeqe apo transfertë elektronike nga palë të treta me të cilët nuk duket se ka lidhje.
- n. Klienti hap disa llogari për subjekte ligjore që kontrollohen nga ky klient.
- o. Klienti alokon depozita hyrëse nga palë të treta midis llogarive të shumta.
- p. Klienti, që dyshohet se keqpërdor këtë sektor, njihet se ka miq apo familjarë që punojnë në tregun e letrave me vlerë.
- q. Tregtim i madh ose i përsëritur në letra me vlerë që janë jolikuide, nën vlerë apo të vështira për t'i vënë çmim.
- r. Punonjësit e një firme letrash me vlerë bëjnë një jetë luksoze që nuk përputhet me rrogën e tij/saj apo pozicionin, nuk pranojnë të marrin lejen vjetore ose që dihet që kanë probleme financiare, personale apo të tjera.
- s. Subjekte me struktura komplekse korporatash.
- t. Persona të ekspozuar politikisht(PEP).

2.3. Raste studimi në sektorin e letrave me vlerë

Tregues:

- **Përdorimi i një kompanie inaktive publike (që tregohet në shkëmbimin e aksioneve);**

- **Përdorimi i një koperturë/apo ortakut të rremë të kryejë blerjet -Transferimi i fondeve në disa llogari;**
- **Përdorimi i biznesit të shërbimit të parave (MSB) për të transferuar fondet;**
- **Tërheqja e fondeve pak pas blerjes me anë të kredive -Transferimi i fondeve tek i njëjti MSB.**

Përshkrimi i rastit: Veç kompanisë X, D ishte dhe pronar i vetëm i një kompanie Y. D përdorte kompaninë Y për të blerë interesa të kontrolluar në kompaninë X nëpërmjet tregut OTC. Një pjesë e 2.5 milion dollar që i ishte kredituar kompanisë X ishte marrë nga llogaria e kompanisë Y. Kompania Y merrte shumën të mëdha depozitash nga disa llogari private që menaxhoheshin nga subjekte kriminale të përfshira në trafikimin e drogës. Në një rast fondet ishin transferuar nga një person që dihej se ishte përfshirë në një aktivitet kriminal nëpërmjet një llogarie MSB në llogarinë e kompanisë X për të distancuar edhe më shumë burimin e fondeve. Pronarët e rinj të kontrollit vendosën drejtorë të rinj, përfshirë anëtarët e familjes. Pak kohë pasi 2.5 milion dollar u transferuan në llogarinë e kompanisë X, u transferua sërish mbrapsht te llogaria MSB. Disa prej parave u transferuan si kredi kompanisë E, e cila ishte e lidhur me të njëjtën organizatë kriminale që transferoi fillimisht fondet e Kompanisë Y.

D dhe familja e tij ishin të njohur për NJIF-in, pasi kishin ngritur kompani inaktive dhe në të shkuarën me qëllim pastrimin e parave, përfshirë kryerjen e veprave të tjera penale. Ata dyshoheshin se me forma të tjera mashtrimi ndikonin në lëvizjen e çmimit të aksioneve të kompanive të tyre, duke kryer transferimin rrethor të fondeve dhe me forma mashtrimi zhvendosnin fondet nga kompanitë.

Tabela 1. Kategorizimi i klientëve

	Numri total i klientëve të subjektit	Gjendja (teprica) e llogarive të klientëve në fund të periudhës raportuese (në mijë lekë)**	Pesha (në %) e numrit të klientëve të çdo kategorie ndaj numrit total të klientëve	Pesha (në %) e gjendjes (tepricës) së llogarive për çdo kategori ndaj totalit të gjendjes (tepricës) së llogarive
Kategoritë sipas rrezikut				
KATEGORIA ME RREZIK TË LARTË				
Persona të ekspozuar politikisht (PEP)				
Organizata jofitimprurëse (OJF)				
Kompani jorezidente				
Individë jorezidentë				
Klientë <i>Offshore</i>				
Të tjerë, nëse ka				
KATEGORIA ME RREZIK TË MESËM				
Sipas ndarjes së vetë subjektit				
KATEGORIA ME RREZIK TË ULËT				
Sipas ndarjes së vetë subjektit				
TOTALI				

Tabela 2. Kategorizimi i transaksioneve (kur është e aplikueshme)

	Numri total i transaksioneve	Vlera e transaksioneve (në mijë lekë)**	Pesha (në %) e numrit të transaksioneve të çdo kategorie ndaj numrit total të transaksioneve	Pesha (në %) e vlerës së transaksioneve për çdo kategori ndaj vlerës totale të transaksioneve
I. TRANSAKSIONE JASHT VENDIT				
Nga të cilat, transaksionet - që i përkasin kategorisë me rrezik të lartë				
II. TRANSAKSIONE NENDA VENDIT				
nga të cilat, transaksionet - që i përkasin kategorisë me rrezik të lartë				
TOTALI I TRANSAKSIONEVE				

Tabela 3. Të dhëna shtesë

Subjekti	Viti paraardhës	Viti raportues
Numri i RAD të raportuara		
Numri i rasteve të analizuara nga subjekti, me dyshime për pastrim të parave ose financim terrorizmi (jo RAD)		
Numri i rasteve të analizuara nga deget/agjentët		
Masat administrative (në vlerë)		

ANEKS 5*

PYETËSOR PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE (PPP)/ PARANDALIMIN E FINANCIMIT TË TERRORIZMIT (PFT)

PJESA 1: INFORMACION MBI SUBJEKTIN

Emri i subjektit	
Drejtori i përgjithshëm	
Personi përgjegjës për PPP/PFT	
Struktura përgjegjëse në degë/agjenci për PPP/PFT	
Adresa	
Tel/Faks:	
Web:	
Sa degë/agjenci ka subjekti?	_____

* Këto të dhëna dërgohen pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare një herë në vit, në formë të printuar dhe në rrugë elektronike.

PJESA 2: NJIH KLIENTIN TËND (NKT) / KËRKESA PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE (PPP) / PËR PARANDALIMIN E FINANCIMIT TË TERRORIZMIT (PFT)

2.1 Praktika dhe procedura të përgjithshme për parandalimin e pastrimit të parave		
1	A jeni ju apo ndonjë punonjësi juaj aktualisht (ose gjatë periudhës raportuese) subjekt i ndonjë hetimi, akuze, dënimi apo padie civile lidhur me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit? (Përgjigjja mund të mbështetet në formularët e vetëdeklarimit të nënshkruar nga vetë punonjësit, si dhe në verifikimet që subjekti mund të kryejë për raste të veçanta ose për të gjitha rastet.)	PO ____ JO____
2	A i përmbush subjekti rekomandimet e FATF?	PO ____ JO____
3	A ka subjekti degë në ndonjë nga vendet që konsiderohen “jo bashkëpunuese” nga FATF?	PO ____ JO____
4	A miratohen nga Personi Përgjegjës i subjektit, politikat për PPP/PFT?	PO ____ JO____
5	A ka subjekti procedura të shkruara, që dokumentojnë proceset për parandalimin, identifikimin dhe raportimin e transaksioneve të dyshimta?	PO ____ JO____
6	Sa kontrole janë kryer gjatë periudhës së raportuar, për vlerësimin e politikave/procedurave për PPP/PFT nga:	Autoritetet mbikëqyrëse Autoritetet përgjegjëse Kontrolli i brendshëm
7	A ka subjekti politika/procedura që mbulojnë marrëdhëniet me Personat e Ekspozuar Politikisht, në përputhje me kërkesat ligjore/rregullative?	PO ____ JO____
8	A ka subjekti procedura të ruajtjes së të dhënave, në përputhje me legjislacionin në fuqi?	PO ____ JO____
9	A kërkon subjekti që politikat dhe procedurat e PPP-së të zbatohen në të gjitha degët dhe filialet e tij, brenda dhe jashtë vendit?	PO ____ JO____
2.2 Vlerësimi i rrezikut		
10	A kryen subjekti një vlerësim të bazuar mbi rrezikun, të bazës së klientëve dhe të transaksioneve të kryera?	PO ____ JO____
11	Nëse përgjigjja e pyetjes 11 është “Po”, përcaktoni rreziqet e identifikuar nga vlerësimi.	PO ____ JO____

2.3. Njih klientin tënd, vigjilenca e duhur dhe vigjilenca e zgjeruar

12	A ka subjekti politika që ndalojnë hapjen dhe mirëmbajtjen e llogarive anonime (d.m.th. llogari të identifikuar me numra, për të cilat subjekti nuk e di kush është pronari)?	PO ____ JO ____
13	A ka subjekti sisteme për identifikimin e klientëve të tij, në rastin e hapjes së llogarive/vendosjes së marrëdhënieve të biznesit (që përfshijnë për shembull: emrin, shtetësinë, adresën, numrin e telefonit, datëlindjen, numrin dhe llojin e dokumentit të identifikimit dhe shtetin që e ka lëshuar atë)?	PO ____ JO ____
14	A ka subjekti kërkesa për mbledhjen e informacionit lidhur me aktivitetet e biznesit të klientëve të tij?	PO ____ JO ____
15	Shfuqizohet	

2.4 Transaksionet e raportueshme dhe identifikimi e parandalimi i transaksioneve me fonde të siguruar në mënyrë të paligjshme.

16	A ka subjekti procedura për identifikimin dhe raportimin e transaksioneve, të cilat duhet të raportohen tek autoritetet?	PO ____ JO ____
17	A ka subjekti politika/procedura, infrastrukturën e duhur apo kontrole për parandalimin ose identifikimin e transaksioneve të strukturuar?	PO ____ JO ____
18	A i monitoron subjekti transaksionet për klientët ose transaksionet që vlerëson se janë me rrezik të lartë (ku mund të përfshihen persona, subjekte apo shtete të përfshira në listat e shpërndara nga qeveria organizma ndërkombëtare), për të cilat nevojitet një vëmendje e veçantë ndaj këtyre klientëve apo transaksioneve para kryerjes së çdonjërit nga këto transaksione?	PO ____ JO ____
19	A e kontrollon subjekti bazën e të dhënave të klientëve përkundrejt listave të përditësuara të individëve/subjekteve, për t'u siguruar që nuk i ofron shërbime financiare ose nuk kryen transaksione biznesi me këta individë/subjekte, me qëllim identifikimin e aktiviteteve jo të zakonshme?	PO ____ JO ____
20	Si bëhet kontrolli i bazës së të dhënave?	Manuale ____ Automatike ____

21	A ka subjekti marrëdhënie biznesi me politikanë ose figura zyrtarësh të lartë, ose me anëtarët e ndonjë regjimi që ka gjasa të jenë të përfshirë në korrupsion ose aktivitete të tjera të paligjshme?	PO ____ JO ____
22	shfuqizuar	
23	shfuqizuar	
2.5 Përputhshmëria me aktet ligjore dhe nënligjore për PPP/LFT		
24	A janë të parashikuara ndryshimet në rregulloret/udhëzimet apo proceduart e brendshme, në lidhje me PPP/LFT në planet e auditimeve të subjekteve?	PO ____ JO ____
25	A ka ngritur subjekti një njësi për PPP/LFT?	PO ____ JO ____
2.6 Trajnimi për PPP/LFT		
26	A u ofron subjekti trajnime për PPP/PFT punonjësve përkatës, që përfshijnë identifikimin dhe raportimin e transaksioneve që duhet të raportohen te autoritetet përgjegjëse, shembuj të formave të ndryshme të pastrimit të parave duke përfshirë edhe produktet dhe shërbimet e ofruara prej tij, si dhe politikat e brendshme për parandalimin e pastrimit të parave?	PO ____ JO ____
27	A i ruan subjekti të dhënat e seancave të trajnimit, duke përfshirë të dhënat e pjesëmarrjes dhe materialet e përdorura gjatë trajnimit?	PO ____ JO ____
28	A ka subjekti politika për komunikimin me punonjësit përkatës për ndryshimet ligjore/rregullative që lidhen me PPP/PFT?	PO ____ JO ____
29	A ka subjekti agjentë për të kryer disa nga funksionet e tij? Nëse po, a i ofron këtyre agjentëve trajnime për PPP, që përfshijnë identifikimin dhe raportimin e transaksioneve që duhet të raportohen te autoritetet përgjegjëse, shembuj të formave të ndryshme të pastrimit të parave duke përfshirë edhe produktet dhe shërbimet e ofruara prej tij, si dhe politikat e brendshme për parandalimin e pastrimit të parave?	PO ____ JO ____
30	A ka kryer subjekti kontrole të agjentëve për zbatimin e detyrimeve ligjore/rregullative për PPP/PFT?	PO ____ JO ____
31	A është i trajnuar për PPP/LFT personi përgjegjës i emëruar	PO ____ JO ____

	nga subjekti?	
--	---------------	--

Dokumente që i duhen bashkëngjitur përgjigjes suaj:

1. Kopje të politikave/procedurave të subjektit në lidhje me PPP/PFT;
2. Kopje e vlerësimit të rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit të kryer nga subjekti;
3. Informacion përmbledhës mbi gjetjet, rekomandimet dhe masat e marra nga kontrolli i brendshëm për çështjet e PPP/PFT, gjatë periudhës së raportuar;
4. Informacion përmbledhës për trajnimet e kryera për strukturën përgjegjëse dhe punonjësit e përfshirë në procesin e PPP/PFT.

Unë konfirmoj që informacioni i mësipërm është i përditësuar, i saktë dhe pasqyron politikat:
 Njih Klientin Tënd / Parandalimit të Pastrimit të Parave / Parandalimit të Financimit të Terrorizmit të subjektit që përfaqësoj.

Emri:	Numri i telefonit:
Pozicioni:	E-mail:
Data:	Nënshkrimi:

ANEKS VI

POLITIKAT DHE PROCEDURAT E PRANIMIT TË KLIENTËVE

Subjektet identifikojnë në mënyrë të plotë dhe të saktë konsumatorët dhe pronarët përfitues, si dhe kërkojnë informacione shtesë në rastet kur e gjejnë të arsyeshme. Vigjilenca e duhur është një mjet i rëndësishëm njohës, nëse ka baza të arsyeshme ose dyshime të ML/TF. Masat e vigjilencës së duhur për tu zbatuar nga subjektet përfshijnë:

1. Identifikimi e konsumatori dhe verifikimi i identitetit të klientit

Identifikimi dhe verifikimi duhet të bëhet duke përdorur shërbime të besueshme, dokumente burimore të pavarura, të dhëna ose informacione të siguruar nga një person i besueshëm dhe i burim pavarur. Pas verifikimit të identitetit të klientit merren dhe masat përkatëse p.sh. në rast se klienti është PEP, OJF ose klient jorezident vepohet sipas nenit 8 të Ligjit 9917, datë 19.05.2018 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe Financimit të Terrorizmit”, i ndryshuar.

2. Identifikimi i pronarit përfitues

Një pronar përfitues është normalisht një individ i cili përfundimisht zotëron ose kontrollon klientin ose në emër të të cilit është kryer transaksioni ose aktiviteti.

Identifikimi i pronarit përfitues përfshin dhe marrjen e masave të arsyeshme për të verifikuar identitetin e pronarit përfitues në mënyrë të tillë që të krijohet bindja se kush është pronari përfitues, duke përfshirë edhe rastin e një personin juridik ose kujdestari, masa për t'i mundësuar subjektit të kuptojë strukturën e pronësisë dhe të kontrollit të personit juridik ose të kujdestarit.

Pas verifikimit të identitetit të pronarit përfitues merren dhe masat përkatëse p.sh. në rast se klienti është PEP, OJF ose klient jorezident vepohet sipas nenit 8 të Ligjit 9917, datë 19.05.2018 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe Financimit të Terrorizmit”, i ndryshuar.

Në respektimin e një klienti që është një individ që nuk vepron në një kapacitet zyrtar në emër të një personi juridik ose kujdestari, vetë klienti është normalisht pronari përfitues. Nuk ka kërkesa për subjektet për të kryer kërkime proaktive për pronarët përfitues në një rast të tillë, por ata duhet të bëjnë kërkimet e duhura aty ku dallojnë se klienti nuk është duke vepruar në emër të tij.

Kur individi identifikohet si pronar përfitues, subjektet duhet të mbledhin informacionin e mëposhtëm identifikues në lidhje me klientët private që duhet të identifikohen:

- a. Emri i plotë;
- b. Datën e lindjes;
- c. Kombësia; dhe
- d. Lloji dhe numri i dokumentit të identitetit.

Shoqëria e sigurimit të jetës duhet të marrë emrin e përfituesit kur personi fizik ose juridik ose një marrëveshje identifikohet si përfitues; ose të marrë informacion të mjaftueshëm për t'u bindur që identitetet e përfituesve mund të krijohen në kohën e pagimit. Verifikimi i identitetit të përfituesve duhet bërë jo më vonë se në kohën e pagimit, apo në rastin kur firma e di se sigurimi i jetës i është caktuar një pale të tretë që do të marrë vlerën e policës, ata duhet të identifikojnë pronarin përfitues në kohën e caktimit.

Personat juridikë dhe kujdestaret

Për personat juridikë, kërkesa kryesore është të shikohet prapa klientit për të identifikuar ata që kanë kontroll përfundimtar ose pronësinë mbi përfitim përfundimtar mbi biznesin dhe asetet e klientit. FI-të do të paguanin normalisht një vëmendje të veçantë për personat që ushtrojnë kontrollin përfundimtar mbi menaxhimin e klientit.

Për të vendosur se kush është pronari përfitues në lidhje me një person juridik ku klienti nuk është një person fizik, objektivi i subjektit është të dihet se kush ka pronësi ose kontroll mbi personin juridik që lidhet me marrëdhënien, ose që përbën kontrollin e mendjes dhe menaxhimin e çdo subjekti juridik të përfshirë në fonde.

Verifikimi i identitetit të pronarit / përfituesve duhet të kryhet duke përdorur në mënyrë të arsyetuar masat e bazuara në një qasje të bazuar në rrezik.

Kur pronari është një person tjetër juridik ose kujdestar, objektivi është që të ndërmarrë masat e arsyeshme për të parë atë person juridik apo kujdestar dhe për të verifikuar identitetin e pronarëve përfitues. Kontrolli për këtë qëllim lidhet me natyrën e institucionit, dhe mund të përfshijë ata që kanë mandat për të menaxhuar fondet, llogarite apo investimet pa kërkuar autorizim të mëtejshëm.

Për një klient të ndryshëm nga një person fizik, subjektet duhet të sigurojë që ato të jenë plotësisht të kuptueshme me formën ligjore, strukturën dhe pronësinë e klientit, dhe duhet të marrin informacion mbi natyrën e biznesit të tij, dhe arsyet duke kërkuar produktin ose shërbimin në rastet kur arsyet nuk janë të dukshme.

Subjektet duhet të bëjnë rishikime të herëpashershme për të siguruar që informacioni i klientit është i përditësuar dhe relevant; metodat me të cilat mund të kryhet një rishikim përfshijnë kryerjen e kërkimeve të kompanisë, duke kërkuar kopje të vendimeve të emërimit drejtorët, duke theksuar dorëheqjen e drejtorëve, ose me mjete të tjera të posaçme.

Shumë njësi veprojnë në faqet e internetit të internetit, të cilat përmbajnë informacion rreth entitetit.

Subjektet duhet të mbajnë në mend se ky informacion, megjithëse i dobishëm në ofrimin e shumë materialeve që një subjekt mund të ketë nevojë në lidhje me klientin, administrimin e tij dhe biznesi mund të mos jetë në mënyrë të pavarur. Biznesi i verifikuar nuk mund të verifikohet në mënyrë të pavarur.

Situata me rrezik të lartë

Subjektet duhet, që në çdo situatë që paraqet një rrezik më të lartë të PP/FT , të marrin masa shtesë për të zbutur rrezikun e PP/FT. Masat shtesë mund të përfshijë:

- a. Marrjen e informatave shtesë mbi konsumatorin (p.sh. palët e lidhura, llogaritë ose marrëdhëniet) dhe përditësimin më të rregullt të profilit të klientit, duke përfshirë të dhënat e identifikimit;
- b. Marrjen e informatave shtesë mbi destinacionin, natyrën e marrëdhënies afariste (p.sh. veprimtaria e parashikuar e llogarisë), burimi i pasurisë dhe burimi i fondeve;
- c. Marrjen e miratimit nga menaxhmenti i lartë për të filluar ose për të vazhduar marrëdhënien; dhe
- d. Kryerjen e monitorimit të zgjeruar të biznesit duke rritur numrin dhe kohën e kontroleve të zbatuara dhe zgjedhjen e modeleve të transaksioneve që kanë nevojë për ekzaminim të mëtejshëm.

Për shmangien e dyshimit, të gjithë klientët me risk të lartë duhet t'i nënshtrohet rishikimit vjetor.

3. Marrjen e informacion mbi natyrën dhe qëllimin e marrëdhënies së biznesit.

Subjekti duhet të kuptojë synimin dhe natyrën e qëllimshme të marrëdhënies së biznesit. Në disa raste, kjo mund të evidentohet, por në shumë raste subjekti duhet të marrë informacione në lidhje me këtë aspekt.

Përveç kur synimi dhe natyra e qëllimshme janë të dukshme, subjektet duhet të fitojnë informacion të kënaqshëm nga të gjithë klientët e rinj, për qëllimin dhe arsyet, për hapjen e llogarisë ose vendosjen e marrëdhënies afariste dhe regjistrimi i informacionit në lidhje me dokumentin e hapjes së llogarisë.

Në varësi të vlerësimit të rrezikut të subjektit, informacioni që mund të jetë i rëndësishëm mund të përfshijë:

- a. Natyrën dhe detajet e biznesit / profesionit / punësimit;
- b. Nivelin dhe natyrën e parashikuar të veprimtarisë që do të ndërmerret nëpërmjet (p.sh. cilat mund të jenë transaksionet tipike);
- c. Vendndodhja e klientit;
- d. Burimi dhe origjina e pritur e fondeve që do të përdoren në marrëdhënie; dhe
- e. Burimi fillestar dhe i vazhdueshëm i pasurisë ose i të ardhurave.

Kjo kërkesë aplikohet edhe në kontekstin e jorezidentëve. Ndërkohë, shumica dërrmuese e jorezidentëve që kërkojnë të hyjnë në marrëdhënie tregtare me subjektet në Shqipëri janë për arsye legjitime, vetëm disa jo-rezidentë mund të përfaqësojnë një rrezik më të lartë për PP/FT. Në raste të tilla subjekti duhet të kuptojë arsyen pse ky resident kërkon të krijojë një marrëdhënie biznesi në Shqipëri duke marrë masa shtesë për menaxhimin e rreziqeve PP/FT.

4. Identifikimin dhe verifikimin e personit që vepron në emër të klientit

Nëse një person pretendon të veprojë në emër të klientit, subjekti duhet:

i. Të identifikojë personin dhe të marrë masa të arsyeshme për të verifikuar identitetin në bazë të dokumenteve, të dhënave ose informacionit të siguruar nga:

- a. Një organ qeveritar;
- b. Autoriteti përkatës ose ndonjë autoritet tjetër përkatës;
- c. Një autoritet në një vend jashtë Shqipërisë që kryen funksione të ngjashme me ato të autoritetit përkatës ose ndonjë autoritet tjetër përkatës ose
- d. Çdo burim tjetër të besueshëm dhe të pavarur që njihet nga autoriteti përkatës; dhe

ii. Të verifikojë autoritetin e personit për të vepruar në emër të klientit.

Në marrjen e masave të përshtatshme për të verifikuar identitetin e personave që pretendojnë të veprojnë në emër të klientëve (p.sh. llogaria e autorizuar, nënshkruerit dhe avokatët), subjektet duhet të identifikojnë dhe verifikojnë identitetin e tyre të autorizuar për të dhënë udhëzime për lëvizjen e fondeve ose aseteve.

Subjektet duhet të marrin autorizim me shkrim për të verifikuar që individi i cili pretendon të përfaqësojë konsumatorin është i autorizuar për ta bërë këtë.

Subjektet mund të hasin vështirësi në identifikimin dhe verifikimin e nënshkruerit të klientëve që mund të kenë lista të gjata të nënshkruerit të llogarisë, veçanërisht nëse janë të vendosur jashtë Shqipërisë. Në raste të tilla, subjekti mund të miratojë një qasje me bazë risku në përcaktimin e masave të përshtatshme për t'iu përshtatur këtyre kërkesave.

Një tjetër mundësi e rëndësishme identifikimi për klientët jashtë shtetit është përdorimi i ndërmjetësve.

Vigjilenca e zgjeruar

Masat e vigjilencës së zgjeruar mund të jenë të përshtatshme, për të gjitha subjektet që mbikëqyr Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, vetëm në situatat me rrezik të lartë.

UDHËZUES

PËR MATJEN E RREZIKUT NGA PASTRIMI I PARAVE DHE FINANCIMI I TERRORIZMIT

Qëllimi i këtij udhëzuesi është të ndihmojë subjektet e rregullores “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” (në vijim referuar si PPP/LFT), në administrimin e rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Udhëzuesi nuk zëvendëson detyrimet ligjore të subjekteve, por synon t’i ndihmojë ato për të kuptuar dhe administruar rreziket që mund të lindin gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, nëpërmjet këtij udhëzuesi, ofron një qasje të bazuar në rrezik në bazë të standardeve më të mira ndërkombëtare për administrimin efektiv të rreziqeve që vijnë nga pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit. Në këtë kuadër, AMF inkurajon subjektet që të zhvillojnë praktika apo procedura për të vlerësuar dhe parandaluar kryerjen e veprimeve të cilat përdoren për pastrimin e parave apo financimin e terrorizmit.

Udhëzuesi është i destinuar të përdoret nga subjektet e licencuara nga AMF, funksionarët dhe stafin e tyre. Udhëzuesi ka qëllim të ofrojë një sfond të përgjithshëm mbi subjektet e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit (PP/FT), duke përfshirë një përmbledhje të dispozitave kryesore të pastrimit të parave dhe luftës kundra financimit të terrorizmit (PPP/LFT) në Shqipëri; si dhe të ofrojë udhëzime praktike për të ndihmuar institucionet financiare (subjektet) dhe drejtuesit e tyre të lartë në hartimin dhe zbatimin e politikave, procedurave dhe kontrolleve të tyre në zonat përkatëse operacionale, duke marrë parasysh ato rrethana të veçanta në mënyrë që të plotësojnë ligjet përkatëse dhe kërkesat rregullatore të PPP /LFT.

Termi "pastrim parash" përcaktohet në OPMLTF dhe AMLO¹ dhe nënkupton një akt që synon të ketë efektin e bërjes së çdo pasurie:

- a. Që janë të ardhurat e fituara nga komisioni i ndonjë veprë të parashikueshme sipas ligjeve të Shqipërisë, apo ndonjë sjelljeje të tillë që nëse do të kishte ndodhur në Shqipëri do të përbënte një kundërvajtje sipas ligjeve Shqiptare; ose
- b. Që në tërësi ose pjesërisht, drejtpërdrejt ose tërthorazi, perfaqëson të ardhura të tilla, duke i bërë që të mos shfaqen si të tilla.

Termi "financimi i terrorizmit" përcaktohet në OPMLTF dhe AMLO dhe do të thotë:

- a. Sigurimi ose grumbullimi, me çdo mjet, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të çdo prone:

¹ Ligji nr. 9917, "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe Financimin e Terrorizmit ", 2008 (OPMLTF), i ndryshuar me ligjin nr. 10391, datë 03.03.2011 dhe Ligji nr. 66/2012, datë 07.06.2012. Ligji nr.9258.2004 "Mbi Masat për Shtypjen e Financimit të Terrorizmit"; shfuqizuar me Ligjin nr. 157/2013 "Për Masat kundra financimin e terrorizmit "(OPMLTF DHE AMLO).

- i. Me qëllim që të përdoret prona; ose
 - ii. Duke ditur se prona do të përdoret, në tërësi ose pjesërisht, për të kryer një ose më shumë akte terroriste (pavarësisht nëse prona përdoret për raste të tilla);
- b. Vënien në dispozicion e çdo pasurie ose shërbime financiare (të lidhura), me çfarëdo mjeti, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në dobi të një personi që e di, ose që nuk e di nga pakujdesia, se është terrorist ose bashkëpunëtor me terroristët;
 - c. grumbullimin e pasurisë ose kërkimin e shërbimeve financiare (të lidhura) në çdo mënyrë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në dobi të një personi që e di, ose që nuk e di nga pakujdesia, se është terrorist ose bashkëpunëtor me terroristët.

Terroristët ose organizatat terroriste kërkojnë mbështetje financiare për të arritur qëllimet e tyre. Shpeshherë është e nevojshme që ata të errësojnë ose fshehin lidhjet ndërmjet tyre dhe burimet e tyre të financimit. Më pas grupet terroriste duhet të gjejnë mënyra për të pastruar fondet, pavarësisht nëse fondet vijnë nga një burim i ligjshëm ose i paligjshëm, në mënyrë që të jenë në gjendje t'i përdorin ato pa tërhequr vëmendjen e autoriteteve.

I. Përshkrim i përgjithshëm mbi matjen e rrezikut

Subjektet, së pari, identifikojnë rreziqet e mundshme të pastrimit të parave, me qëllim zbatimin e një sistemi efikas të matjes së rrezikut. Këto rreziqe mund të identifikohen në forma nga më të ndryshme, por kryesisht ato identifikohen në bazë të faktorëve të rrezikut.

Me faktorë rreziku do të kuptojmë bashkësinë/grupin e kategorive të klientëve, produkteve dhe shërbimeve/transaksioneve, si dhe zonës gjeografike të përcaktuar nga burime të besueshme informacioni si grup kategorish gjerësisht të pranuar për të vlerësuar rrezikun.

Institucionet financiare duhet të zbatojnë sisteme adekuate dhe të përshtatshme të PPP / LFT (duke përfshirë politikat dhe procedurat e pranimit të klientëve) duke marrë parasysh faktorët duke përfshirë produktet dhe shërbimet e ofruara, llojet e konsumatorëve, vendndodhjet gjeografike të përfshira.

Me burime të besueshme informacioni në këtë udhëzues, i referohemi informacionit publik, të vënë gjerësisht në dispozicion nga organe të njohura dhe me reputacion, si për shembull Organizata e Kombeve të Bashkuara, FATF, Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Këshilli i Evropës, OFAC, Grupi Egmont, etj.

Drejtimesit e lartë të subjektit financiar duhet të sigurojnë që vlerësimi i rrezikut dhe proceset për zbutjen e tij të kryhen në mënyrë profesionale, me qëllim përmbushjen e të gjitha detyrimeve ligjore në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe parandalimit e çdo veprimi të paligjshëm, i cili synon pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.

Identifikimi i nivelit të rreziqeve të mundshme ndihmon subjektet për të marrë masat e duhura për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit. Identifikimi i rreziqeve fillon që në momentin e parë që klienti kërkon të hyjë në marrëdhënie biznesi

me subjektin. Në vazhdim, identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve do të bëhet më evident gjatë zhvillimit të marrëdhënies së biznesit.

Subjekti, pasi ka përcaktuar faktorët e rrezikut, bën përcaktimin e kategorive të faktorëve të rrezikut.

Me kategori të faktorit të rrezikut do të kuptojmë llojet e klientëve si dhe llojet e produkteve dhe të shërbimeve që subjekti u ofron klientëve, llojet e transaksioneve si dhe zona gjeografike prej të cilës klientët janë (prejardhja/vendndodhja) ose kanë marrëdhënie biznesi.

Në vazhdim të procesit të identifikimit të rreziqeve të mundshme, pasi subjekti ka krijuar kategoritë e faktorëve, realizohet procesi i monitorimit të këtyre kategorive, i cili shërben si një nga proceset më të rëndësishme në matjen e rrezikut. Në vijim të procesit të monitorimit realizohet procesi i analizës. Megjithatë, vlerësohet se nuk ekziston një ndarje racionale e mirëfilltë midis procesit të monitorimit dhe procesit të analizës. Të dyja këto procese, për shumë subjekte mund të nënkuptojnë ndërmarrjen e masave të njëjta, por për efekt të këtij udhëzimi do të pranojmë se “analiza” është pjesë e procesit të monitorimit dhe përfshin masat më të përforcuara të tij, duke ruajtur të dhëna / konkluzione me shkrim, të cilat i paraqiten autoriteteve kompetente. Analizimi i transaksioneve përbën bazën e ngritjes së sistemit të PPP/LFT nga subjektet sepse është produkti (*output-i*) i të gjithë këtij procesi. Analizimi i kategorive të faktorëve të rrezikut do të kryhet në bazë të variablave të kategorive.

Me variabël kategorie do të kuptojmë atë element bazë të kategorisë së faktorit, i cili shërben për të gjykuar rreth përputhshmërisë së profilit të klientit me profilin e transaksioneve, si dhe destinacionin e fondeve.

Identifikimi i faktorëve të rrezikut si dhe kategorive të faktorëve lejon zbatimin e një përjasje të bazuar në rrezik. Kjo **qasje e bazuar në rrezik**, mundëson strukturat e subjektit të përqendrohen në çështje, të cilat mbartin ekspozim më të madh ndaj rrezikut. Subjekti duhet të vlerësojë kapacitetet e tij për të ndërtuar një përjasje të tillë, duke identifikuar dhe vlerësuar “mundësitë”, “dobësitë”, “rreziqet”, si dhe “fuqitë” e tij për të përfituar nga kjo metodologji.

Subjektet duhet të ndërtojnë procese për identifikimin, matjen, monitorimin dhe zbutjen e rreziqeve që vijnë nga pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit, me qëllim zbatimin e një

qasje të bazuar në rrezik. Këto procese duhet të mbështeten nga politika, procedura, struktura të dedikuara, trajnime si dhe sisteme kontrolli të cilat realizojnë identifikimin dhe administrimin në mënyrë efektive të ekspozimit ndaj rrezikut. Kontrolli i brendshëm i subjektit vlerëson, në mënyrë të vazhdueshme, tërësinë e funksionimit të këtyre proceseve. Strukturat më të larta drejtuese të subjektit, aprovojnë sistemin e ndërtuar.

Në rastet kur subjektet identifikojnë ekspozim të lartë ndaj rrezikut, aplikojnë masa të përforcuara për administrimin dhe zbutjen e ekspozimit ndaj rreziqeve.

II. Niveli i rrezikut

Subjektet identifikojnë rrezikun, duke kryer vlerësime ose matje në dy drejtime kryesore:

- Në ndikimin (dëmin) që mund të shkaktohet, në rast se ndodh një ngjarje, e cila është shoqëruar ose ka shkakuar pastrim parash apo financim të terrorizmit; dhe
- Në mundësinë e realizimit të ngjarjes, e cila mund të shoqërohet ose shkaktojë pastrim parash apo financim të terrorizmit.

Subjektet, në varësi të vlerësimit të mundësisë apo pasojave që mund të sjellë kryerja e një ngjarjeje, e cila çon në pastrim parash apo financim të terrorizmit, mund të kryejnë vlerësimin e rrezikut në këndvështrime të ndryshme. Pavarësisht kësaj, gjykohet se në përputhje me kuadrin ligjor, dy janë nivelet e kategorizimit të rrezikut:

- **Niveli i ulët dhe niveli i mesëm ose i moderuar i rrezikut** - kur mundësia që të ndodhë pastrim parash dhe financim terrorizmi është e vogël dhe/ose të ketë pasoja të vogla ose të papërfillshme për subjektin. Në këto raste, zbatohen gjithmonë masat e vigjilencës së duhur të parashikuar në ligj apo aktet nënligjore.

- **Niveli i lartë i rrezikut** - kur ekziston mundësia që të ndodhë pastrim parash dhe financim terrorizmi dhe/ose të ketë pasoja, të cilat mund të konsiderohen të dëmshme ose shumë serioze për subjektin. Në këto raste, zbatohen gjithmonë masat e vigjilencës së zgjeruar të parashikuar në ligj apo aktet nënligjore.

Megjithatë, subjektet nga ana e tyre mund të përdorin një përjasje të tillë, e cila e kategorizon rrezikun në tre nivele: niveli i ulët, i mesëm dhe i lartë, por niveli me rrezik të ulët dhe niveli me rrezik të mesëm duhet të kanalizohen në kategorinë e vigjilencës së duhur.

III. Faktorët e rrezikut

Subjektet konsiderojnë faktorë gjerësisht të pranuar (më të përdorur) të identifikimit dhe matjes së rrezikut, të cilët janë: rreziku gjeografik, rreziku i klientit, si dhe rreziku i produktit dhe shërbimeve/transaksioneve.

Subjektet bazohen në këta tre faktorë, të cilët përbëjnë minimalisht faktorët që shërbejnë për matjen e rrezikut.

Subjekte të ndryshme mund të aplikojnë pesha ponderimi të ndryshme për këta faktorë (individualisht apo në kombinim) në vlerësimin e rrezikut, në varësi të aktivitetit dhe rrethanave përkatëse. Rrjedhimisht, subjektet do të duhet të bëjnë përcaktimin e këtyre peshave dhe arsyetimin përkatës për madhësinë e peshave të zgjedhura/aplikuara. Këto pesha janë subjekt i vlerësimit gjatë kontrolleve në vend, në përputhje me profilin,

strategjinë si dhe vizionin e subjektit. Në vijim peshat e ponderimit që përfton çdo faktor rreziku, do ti përkufizojmë si “koeficientët e ponderimit të faktorit të rrezikut”.

Të gjitha kategoritë e përcaktuara në kuadrin ligjor dhe udhëzimet përkatëse, të cilat kanalizohen në procesin e vigjilencës së zgjeruar, mbartin vlerën e rrezikut më të lartë pra koeficientët e ponderimit më të lartë. Kjo nënkupton që rezultati i sistemit të ndërtuar nga subjekti duhet të kanalizojë automatikisht marrëdhënien e biznesit me klientin në kategorinë e Vigjilencës së Zgjeruar. Për shembull, në rastin që një PEP kryen një transaksion, marrëdhënia kanalizohet automatikisht në procesin e vigjilencës së zgjeruar dhe si rrjedhim, subjekti duhet të marrë të gjitha masat në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullativ në fuqi.

Nuk ka një metodologji të vetme për të zbatuar faktorët e rrezikut. Aplikimi i tyre (faktorëve) ka për qëllim të ofrojë një strategji për administrimin e rreziqeve të mundshme dhe këta faktorë konsiderohen të jenë tregues të dobishëm, por jo domosdoshmërisht, për të gjitha rastet apo rrethanat.

Subjektet ndërtojnë sistemet e tyre, në mënyrë të tillë që identifikojnë minimalisht faktorët dhe kategoritë e përcaktuara në këtë udhëzim, të cilat mbartin nivelin më të lartë të rrezikut. Subjektet mund të përcaktojnë edhe kategori ose faktorë të tjerë në përputhje me profilin e tyre të segmentimit në tregjet financiare.

1. Faktori “Rreziku gjeografik” – është rreziku i përcaktuar nga pozicioni gjeografik i vendit të origjinës së klientit (pronarit përfitues) dhe / ose vendndodhjes së personit të përfshirë në një transaksion me klientin.

Kategoritë e rrezikut gjeografik, të cilat mund të rezultojnë në konstatimin se një vend paraqet një rrezik më të lartë përfshijnë:

- Vende që i nënshtrohen sanksioneve, embargove ose masave të ngjashme, si për shembull vende/entitete/persona të cilët janë të përfshirë në rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara;
- Vende që identifikohen nga burime të besueshme se kanë mungesa të kuadrit ligjor dhe rregullativ të PPP/LFT të tilla si vende të cilat janë identifikuar nga FATF, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Moneyval, Banka Botërore, Egmont Group etj.;
- Vende të identikuara nga burime të besueshme informacioni si ofrues të fondeve apo përkrahës për aktivitetet terroriste që kanë krijuar organizata terroriste që veprojnë brenda tyre;
- Vende të identikuara nga burime të besueshme, që kanë nivele të konsiderueshme korrupsioni ose ndonjë aktivitet tjetër kriminal si vende të identikuara nga Banka Botërore, FMN ose FATF.

Vlerësimi dhe matja e rrezikut varen gjithashtu edhe nga vendndodhja e subjektit ose vendndodhja e njërive organizative të tij, duke nënkuptuar nivel të ndryshëm të rrezikut të

subjekteve të vendosura në një zonë që vizitohet nga shumë turistë, krahasuar me ato të një zone rurale, ku të gjithë klientët njihen personalisht.

Rreziku mund të jetë në nivel më të lartë në pikat kufitare, aeroporte, në vendet me përqendrim të lartë të të huajve ose në rastet e transaksioneve që përfshijnë të huajt (për shembull panairë), në vendet ku janë vendosur ambasadat apo zyrat konsullore, në vendet me rrezik të lartë të korrupsionit dhe krimit, etj.

Rrezik të lartë paraqesin gjithashtu edhe transaksionet e ekzekutuara në destinacionet *off-shore*.

Variablat që ndikojnë në kategorizimin e rrezikut, sipas faktorit gjeografik, janë:

1. Luhatje e bazës së të siguarve;
2. Bazë ndërkuftare e të siguarve;
3. Të siguar në vende me mungesa legjislacioni për PPP/FT (identifikuar nga FATF, FMN, Moneyval, B.B., Egmont Group.);
4. Të siguar në vende të identikuara nga burime të besueshme, që kanë nivele të konsiderueshme korrupsioni ose ndonjë aktivitet tjetër kriminal (identifikuar nga B.B., FMN ose FATF);
5. Mbi 5% e PSHB në vende të identikuara me nivele të konsiderueshme korrupsioni ose ndonjë aktivitet tjetër kriminal.

2. Faktori “Rreziku i klientit / entitetit”².

Një kategori e caktuar klientësh mund të konsiderohen se mbajnë Rreziqet më të ulëta të PP/FT, si p.sh.:

- a. Konsumatorët të cilët janë të punësuar, me një burim të rregullt të ardhurave nga një burim i njohur legjitim; dhe
- b. Klientët me reputacion të mirë p.sh. një kompani e njohur me reputacion privat, me një histori të gjatë që është dokumentuar nga burime të pavarura, duke përfshirë informacion në lidhje me pronësinë dhe kontrollin.

Megjithatë, disa konsumatorë, sipas natyrës ose sjelljes së tyre, mund të paraqesin një risk më të lartë i PP/FT.

Faktorët mund të përfshijnë:

- a. Profilin publik të konsumatorit që tregon përfshirjen me, ose lidhjen me PEP;
- b. Kompleksitetin e marrëdhënies, duke përfshirë përdorimin e strukturave të korporatave, kujdestarin dhe përdorimin e aksioneve të emëruar dhe bartësit ku nuk ka arsyetim tregtar legjitim.
- c. Një kërkesë për përdorimin e llogarive të numëruara ose nivelet e panevojshme të sekretit me një transaksion;
- d. Përfshirja në bizneset intensive;
- e. Natyra, fushëveprimi dhe vendndodhja e aktiviteteve të biznesit që gjenerojnë fondet/asetet, duke pasur parasysh aktivitetet e ndjeshme ose me rrezik të lartë; dhe

² Trajtuar në Aneks 1 dhe Aneks 2, sipas tregjeve.

- f. Ku origjina e pasurisë (për klientët me rrezik të lartë dhe PEP) ose pronësia nuk mund të verifikohet lehtë etj.

Variablat që ndikojnë në kategorizimin e rrezikut, sipas faktorit klient/entitet, janë:

1. Të siguar me rrezik të lartë (me rekord kriminal, PEP etj.);
2. Të siguar me përfitues me rrezik të lartë (me rekord kriminal, PEP etj.);
3. Numri i SAR-eve në 12 muajt e fundit;
4. Të siguar të dyshuar për FT.

3. Rreziku i produkteve dhe shërbimeve/kategoritë e transaksioneve dhe marrëdhënieve të biznesit³.

Faktorët që paraqesin rrezik më të lartë janë:

- a. Shërbimet që paraqesin më shumë anonimitet; dhe
- b. Aftësia për të bashkuar klientët themelorë/fondet.

Variablat që ndikojnë në kategorizimin e rrezikut, sipas faktorit produkte dhe shërbime/kategoritë e transaksioneve dhe marrëdhënieve të biznesit, janë:

1. Numri i RTPF në 12 muajt e fundit (transaksione në para fizike > 1 milion Lekë);
2. Sigurime të përdorura si kolateral, për pagesa ose për vetë-shërbim të konsumatorëve;
3. Investime Komplekse (Unit-linked...) si % e aktiveve ne total;
4. Shitje jo të drejtpërdrejta nëpërmjet internetit, kanaleve postare/telefonike, ndërmjetësve.

IV. Variablat e kategorisë

Subjektet, për të vlerësuar kategoritë e faktorit duhet të kenë parasysh minimalisht variablat e mëposhtëm, të cilët mund të vlerësohen individualisht ose të kombinuar midis tyre:

1. Efektiviteti i auditit të brendshëm;
2. Zbatueshmëria e rekomandimeve nga e Inspektimeve të mëparëshme (AMF, DPPP, Audit i jashtëm, Audit i brendshëm);
3. Niveli i kontrolleve të automatizuara;
4. Vetëvlerësimi i Riskut të PPP, nga vetë subjekti;
5. Zbatueshmëria e masave të vigjilencës së duhur dhe vigjilencës së zgjeruar;
6. Përputhshmëria me aktet ligjore dhe nënligjore;
7. Niveli i stafit PPP/Sanksioneve;

³ Trajtuar në Aneks 1 dhe Aneks 2 sipas tregjeve.

8. Trajnimi i stafit PPP.

Sasia e trajnimeve vjetore të stafit për PPP, përfshirë personi përgjegjës, dhe punonjësit e subjekteve

V. Hapat e matjes së rrezikut

Subjektet ndjekin hapat e mëposhtme për matjen e ekspozimit ndaj rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit:

- a. Monitorimi në mënyrë të vazhdueshme i marrëdhënieve të biznesit me klientin, bazuar në profilin e transaksioneve, profilin e klientit dhe profilin e ekspozimit ndaj rrezikut gjeografik, gjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj marrëdhënieje, për t'u siguruar se ato janë në përputhje me njohuritë që subjekti ka për tërësinë e variablave të kategorive. Në këtë hap, klientët, produktet dhe shërbimet që ata përdorin si dhe destinacionet e produkteve janë të klasifikuar në kategori të vigjilencës së duhur dhe të zgjeruar. Në çdo ndryshim të mundshëm të variablave të kategorive, subjektet vlerësojnë rrezikun. Subjekti, pasi është identifikuar një ndryshim potencial i variablave, vlerëson rezultatin për të tre kriteret e rrezikut, duke zhvilluar analizën e rastit. Kjo analizë nënkupton shumën e faktorëve të rrezikut, ku secili faktor është ponderuar me koeficientët e ponderimit të faktorit të rrezikut.
- b. Subjektet, në rast se rezultati (analizën e bërë) tregon për një rrezik të mundshëm, e mbështesin analizën në tërësinë e ekspozimit ndaj kriterëve të rrezikut, si dhe mbi variablat e kategorisë së faktorit. Disa prej masave shtesë për të administruar këtë ekspozim janë:
 - Informacion shtesë për profilin e klientit (Internet, baza të dhënash publike);
 - Rritje e frekuencës së përditësimit të të dhënave për klientin;
 - Marrjen e informacionit shtesë për burimin e fondeve;
 - Marrjen e informacionit shtesë për arsyet dhe qëllimin e transaksionit;
 - Marrja e miratimit nga drejtuesit e lartë për nisjen dhe vazhdimin e marrëdhënies së biznesit, në rastet kur marrëdhënia e biznesit me klientin është vendosur dhe subjekti konstaton se klienti apo pronari përfitues ka ndryshuar kategori;
 - Monitorim i zgjeruar.

Subjektet mund të përcaktojnë masa të tjera shtesë për administrimin kundrejt këtij ekspozimi. Në këtë hap, subjekti duhet të ketë nxjerrë përfundime referuar analizave të sipërpërmendura, duke ruajtur të dhëna vërtetuese.

Metodologjia e matjes së rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit që është ofruar në këtë udhëzim, përfaqëson një metodë mikse, që

bëhet e mundur nëpërmjet analizës së faktorëve të rrezikut, si dhe të variablave të kategorive.

- c. Strukturat përgjegjëse të subjektit, pasi kanë identifikuar një rast, i cili përfaqëson materialitet, ndjekin hapat për materializimin e dyshimit të arsyeshëm, si dhe marrin të gjitha masat e nevojshme nëse çështja kërkon adresim në Autoritetin Përgjegjës.

Në tabelat bashkëngjitur këtij udhëzimi, paraqitet një model i thjeshtë për të mundësuar materializimin e kërkesave të vlerësimit.

Tabela 1, është tabela në të cilën analizohen faktorët e rrezikut të jashtëm, pra, faktori gjeografik, faktori i klientit dhe faktori i produkteve. Tabela 1.1 realizon matjen e rrezikut të jashtëm.

Tabela 1: Tabela e analizës së faktorëve të rrezikut të jashtëm

Koeficientët	Vlerësim i ekspozimit ndaj rrezikut	Analiza
33%	Rreziku gjeografik	
34%	Rreziku i klientit	
33%	Rreziku i produkteve	
100%	Rezultati:	

Tabela 1.1: Hapat e matjes së rrezikut të jashtëm⁴

Analiza ⁵	Niveli i Rrezikut	Masat
1	Nivel i ulët	Vigjilencë e duhur
1.3	Nivel i mesëm	Vigjilencë e zgjeruar
1.7	Nivel i lartë	Vigjilencë e zgjeruar
2	Raportim në DPPPP	Vigjilencë e zgjeruar

⁴ Referoju pikës “V. Hapat e matjes së rrezikut.”

⁵ Kujdes, këto rezultate kanë dalë në bazë të koeficientëve të ponderimit të faktorëve të rrezikut që janë përdorur në tabelën e matjes së rrezikut. Në çdo rast të përdorimit të koeficientëve të tjerë, institucioni duhet të ndërtojë një analizë në përputhje me filozofinë e kuadrit ligjor për kanalizimin e çështjes në vigjilencë të duhur apo të zgjeruar.

Tabela 2, është tabela në të cilën analizohen faktorët e rrezikut të brendshëm, si: Efektiviteti i auditit të brendshëm; Zbatueshmëria e rekomandimeve nga Inspektimet e mëparshme (AMF, DPPP, Audit i jashtëm, Audit i brendshëm); Përputhshmëria me aktet ligjore dhe nënligjore; Vetëvlerësimi i Riskut të PPP, nga vetë subjekti; Niveli i kontrolleve të automatizuara; Zbatueshmëria e masave të vigjilencës së duhur dhe vigjilencës së zgjeruar; Niveli i stafit PPP/Sanksioneve; Trajnimi i stafit PPP. Tabela 2.1 realizon matjen e rrezikut të brendshëm.

Tabela 2: Tabela e analizës së faktorëve të rrezikut të brendshëm

Koeficientët	Vlerësim i ekspozimit ndaj rrezikut	Analiza
12.5%	Efektiviteti i auditit të brendshëm	
12.5%	Zbatueshmëria e rekomandimeve nga Inspektimet e mëparshme (AMF, DPPP, Audit i jashtëm, Audit i brendshëm)	
12.5%	Niveli i kontrolleve të automatizuara	
12.5%	Vetëvlerësimi i Riskut të PPP, nga vetë subjekti	
12.5%	Zbatueshmëria e masave të vigjilencës së duhur dhe vigjilencës së zgjeruar	
12.5%	Përputhshmëria me aktet ligjore dhe nënligjore	
12.5%	Niveli i stafit PPP/Sanksioneve	
12.5%	Trajnimi i stafit PPP	
100%	Rezultati:	

Tabela 2.1: Hapat e matjes së rrezikut të brendshëm

Analiza	Niveli i Rrezikut	Masat
1	Niveli i ulët	Vigjilencë e duhur
2	Niveli i mesëm	Vigjilencë e zgjeruar
3	Niveli i lartë	Vigjilencë e zgjeruar

Tabela 3, që është matrica e vlerësimit të kriterit, shërben për të përcaktuar nivelin/profilin e rrezikut të ML/TF duke u bazuar në kombinimet e vlerësimeve të rreziqeve të jashtme dhe të brendshme të subjekteve.

Tabela 3: Matrica e vlerësimit të kriterit

<i>Risku i Jashtëm</i>	Raportim në DPPP	I Lartë	Rapotim në DPPP	Rapotim në DPPP
	I Lartë	I Mesëm	I Lartë	I Lartë
	I Mesëm	I Ulët	I Mesëm	I Lartë
	I Ulët	I Ulët	I Ulët	I Mesëm
		I Ulët	I Mesëm	I Lartë
<i>Risku i Brendshëm</i>				